



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

[www.qpz.gov.al](http://www.qpz.gov.al)

**Nr.33**

**11 prill**

**2012**

## P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr. 177, datë 6.3.2012	Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre.....	1569
Vendim i KM nr. 178, datë 6.3.2012	Për incinerimin e mbetjeve.....	1583
Udhëzim i MF dhe MBUMK nr. 3, datë 16.2.2012	Për procedurat, kriteret e përfitimit të kredisë dhe mënyra e administrimit të fondeve kundërpatri, të mbledhura nga grandet japoneze, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 602, datë 24.8.2011 “Për miratimin e mënyrës së përdorimit të fondeve kundërpatri, të mbledhura nga grandet japoneze për sektorin e bujqësisë dhe të ushqimit”, të ndryshuar.....	1602

**VENDIM**  
**Nr. 177, datë 6.3.2012**

**PËR AMBALAZHET DHE MBETJET E TYRE\***

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 29 të ligjit nr. 10 463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**I. QËLLIMI**

1. Qëllimi i këtij vendimi është mbrojtja, ruajtja dhe përmirësimi i cilësisë së mjedisit dhe shëndetit të njeriut përmes minimizimit të ndikimeve negative nga ambalazhet dhe mbetjet e tyre.

2. Vendimi synon:

- a) të parandalojë mbetjet nga gjenerimi i ambalazheve;
- b) të nxitë grumbullimin e diferencuar, ripërdorimin, riciklimin dhe rikuperimin e mbetjeve nga ambalazhet, duke reduktuar sasinë e tyre që asgjësohen përfundimisht;
- c) të vendosë rregulla për prodhimin e ambalazheve dhe menaxhimin e mbetjeve të tyre në të gjitha fazat, si dhe të përcaktojë subjektet përgjegjëse për menaxhimin e tyre.

**II. FUSHA E ZBATIMIT**

Ky vendim zbatohet për të gjitha llojet e ambalazheve të hedhura në treg në Republikën e Shqipërisë dhe për të gjitha mbetjet nga ambalazhet, të përdorura ose të hedhura nga subjektet shtëpiake, bujqësore, industriale, si dhe nga shërbimet e tjera tregtare, përfshi edhe sektorin publik, pavarësisht nga lloji i materialit ambalazhues.

**III. PËRKUFIZIME**

Të gjithë termat e përcaktuar në nenin 3, të ligjit nr. 10 463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, do të shërbejnë si përkufizime dhe do të kenë të njëjtin kuptim edhe në këtë vendim, ndërsa me termat e mëposhtëm, për qëllime të këtij vendimi, nënkuptohen:

1. “Agjencia”, autoriteti publik, siç përcaktohet në kreun X, seksioni 1 të ligjit nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”.

2. “Ambalazh”, përveç përcaktimit të dhënë në ligjin nr. 10 463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, nënkupton edhe të gjitha produktet, pavarësisht nga materiali përbërës, që përdoren për mbajtjen, mbrojtjen, transferimin, shpërndarjen dhe prezantimin e mallrave nga prodhuesi të përdoruesi apo konsumatori, pavarësisht nga fakti nëse malli brenda tyre është lëndë e parë apo produkt i përpunuar. Termi “ambalazh” i referohet çdo objekti apo sendi që përmbush, sipas shtojcës 1, bashkëlidhur këtij vendimi, kriteret e mëposhtme:

2.1 Përmbush funksionin e përmendur më lart, pavarësisht nga funksionet e tjera që ai mund të ketë, si: nuk është pjesë përbërëse e një produkti (malli); nuk është i nevojshëm për të mbështetur apo mbrojtur produktin (mallin) gjatë gjithë ciklit të tij të jetës; dhe nuk synohet që të gjitha elementet e tij të përdoren, të harxhohen apo të asgjësohen së bashku.

2.2 Është projektuar për t’u mbushur në pikat e prodhimit ose shitjes së produktit (mallit) dhe pjesët e tij shiten, mbushen apo projektohen e përdoren për t’u mbushur në pikat e prodhimit ose shitjes, me kusht që të plotësojë funksionin e synuar të ambalazhit.

\* CELEX Reference: 31994L0062

Titulli i direktivës: 94/62/EC e Parlamentit dhe Këshillit Europian e datës 20 dhjetor 1994 “Për ambalazhet dhe mbetjet nga ambalazhet” hyrë në fuqi më 31 dhjetor 1994, e amenduar me Direktivën 2004/Direktivën 2004/12 të Parlamentit Europian dhe të Këshillit Europian të datës 11 shkurt 2004.



2.3 Është pjesë përbërëse e ambalazhit apo element mbështetës i integruar në ambalazh, me kusht që të mos jetë pjesë përbërëse e produktit (mallit) dhe nuk synohet që të gjitha elementet e tij të përdoren apo të asgjësohen së bashku.

3. “Ambalazh i grupuar ose ambalazh i dytë”, njësia ambalazhuese që përmban një grup produktesh (mallra) të paketuara në ambalazhe shitjeje, në mënyrë që produkti të merret nga konsumatori, qoftë në ambalazh të grupuar, qoftë në ambalazh shitjeje. Ai mund të hiqet nga produkti pa ndikuar në karakteristikat e tij. Nëse ambalazhet e grupuara, në të njëjtën kohë, kanë dhe funksionin e ambalazheve për shitje, ato konsiderohen si ambalazhe shitjeje.

4. “Ambalazh me shumë përdorime”, ambalazhi, i cili, pasi është boshatisur, ripërdoret për të njëjtin qëllim.

5. “Ambalazh me shumë shtresa”, ambalazhi i përbërë nga materiale të ndryshme, të cilat nuk mund të ndahen në mënyrë manuale.

6. “Ambalazhe plastike që nuk biodegradohen”, ambalazhet plastike që janë me përbërës, të cilët nuk janë të biodegradueshëm.

7. “Ambalazhe plastike të biodegradueshme”, ambalazhet që janë prodhuar dhe janë plotësisht të biodegradueshme dhe të dekompozueshme.

8. “Ambalazh shitjeje ose ambalazh i parë”, njësia e ambalazhit në të cilën shitet produkti te konsumatori. Këtu përfshihen dhe pjatat, lugët, pirunët e thikat njëpërdorimshme, si dhe çdo ambalazh i cili mbushet në vendin e shitjes së produktit (mallit) te konsumatori.

9. “Ambalazh transporti ose ambalazh i tretë”, ambalazhet që përdoren për të lehtësuar lëvizjen dhe transportin e një sasive të caktuar produktesh, të paketuara në ambalazhe shitjeje dhe/ose në ambalazhe të grupuara dhe që shërbejnë për të parandaluar dëmtimin e mundshëm të tyre gjatë transferimit fizik dhe transportit. Ambalazh transporti mund të jetë një fuçi, kuti, thes, paletë. Në këtë lloj ambalazhi nuk përfshihen kontejnerët për transportin rrugor, hekurudhor, detar dhe ajror të mallrave, përveç kur këto, në të njëjtën kohë, kanë dhe funksionin e ambalazheve për shitje duke u konsideruar ambalazhe shitjeje.

10. “Ambalazhues”, çdo subjekt, tregtar apo shtetëror, i cili paketon mallra (produkte) dhe i hedh ato në treg për qëllime të aktivitetit të tij.

11. “Biodegradim” ose “Degradimi biotik”, shpërbërja ose dekompozimi i mbetjeve të ambalazheve nga bakteret ose me mënyra të tjera biologjike.

12. “Furnizues i fundit”, subjekti tregtar që shpërndan mallra të ambalazuara në ambalazhe shitjeje, ambalazhe të grupuara apo ambalazhe transporti drejtpërdrejt te konsumatori, pavarësisht nëse ky subjekt është apo jo edhe prodhues ose importues i këtyre mallrave.

13. “Konsumator”, personi, fizik ose juridik, që e nxjerr produktin nga ambalazhi për ta konsumuar përfundimisht.

14. “Kosto e menaxhimit të mbetjeve”, tarifa sipas llojit të materialit të ambalazhit, me qëllim mbulimin e shpenzimeve për menaxhimin e tyre. Këtu përfshihen shpenzimet e grumbullimit të diferencuar, qendrat e transferimit dhe diferencimit të mëtejshëm, të magazinimit të përkohshëm, transportimit të tyre për në vendet e trajtimit.

15. “Marrëveshje vullnetare”, marrëveshja e përfunduar ndërmjet autoriteteve publike kompetente nga njëra anë dhe subjekteve ose sektorëve ekonomikë të interesuar nga ana tjetër, e hapur për të gjitha palët që kanë interesa të ligjshme dhe marrin përsipër të plotësojnë kushtet e parashikuara në këtë marrëveshje dhe objektivat e përcaktuar në këtë vendim.

16. “Material ambalazhi”, materiali nga i cili prodhohet ambalazhi. Materialet e ambalazheve që rregullohen nga ky vendim janë; i) letra, kartoni, kartoni i rrudhosur; ii) qelqi; iii) druri; iv) qeramika, porcelani; v) metalet; vi) fibrat tekstile; vii) plastika; viii) kompozitet; ix) materiale ambalazhi të tjera, në veçanti ato me bazë biologjike.

17. “Mbetje bashkiake”, mbetjet nga ambalazhet, që shkaktohen si pasojë e përdorimit të produkteve të ambalazuara në sektorin shtëpiak, në administratë, në vende sociale dhe publike. Këtu përfshihen edhe mbetjet nga tregtia, aktivitetet e punës me dorë, të shërbimeve apo aktivitetet e tjera që

janë të ngjashme me mbetjet nga ambalazhet të shkaktuara nga sektori shtëpiak, administrata, vendet publike apo sociale.

18. “Mbetje jobashkiake”, mbetjet nga ambalazhet që shkaktohen si pasojë e prodhimit, shitjes së mallrave apo aktiviteteve të ngjashme me to.

19. “Mbetje nga ambalazhi”, të gjitha ambalazhet ose materialet e tyre të biodegradueshme ose jo të biodegradueshme, të përcaktuara në vendimin nr. 99, datë 18.2.2005 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e katalogut shqiptar të mbetjeve”, nën kodin 1501 (kodet 15 01 01 deri 15 01 11\*) dhe përfshijnë çdo ambalazh ose material ambalazhimi, i cili mbetet pas nxjerrjes dhe veçimit të produktit nga ambalazhi, duke përfshirë mbetjet nga prodhimi.

20. “Menaxhimi i mbetjeve nga ambalazhet”, grumbullimi, magazinimi i përkohshëm, transportimi, riciklimi, rikuperimi i tyre, përfshirë dhe mbikëqyrjen e këtyre operacioneve.

21. “Ministri”, ministri përgjegjës për mjedisin.

22. “Ministria”, ministria përgjegjëse për mjedisin.

23. “Njësi e qeverisjes vendore”, komuna, bashkia, qarku dhe nënndarjet e tyre, në përputhje me ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, të ndryshuar.

24. “Operator ekonomik” ka kuptimin që jepet në ligjin nr. 10 463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”.

25. “Parandalim” ka kuptimin që jepet në ligjin nr. 10 463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”.

26. “Prodhues i mallrave të ambalazuara”, çdo subjekt tregtar, person, fizik dhe/ose juridik, i cili prodhon ose importon dhe hedh në treg për qëllim të aktivitetit të tij tregtar mallra të mbështjella në ambalazhe shitjeje, ambalazhe të grupuara apo në ambalazhe transporti, si dhe prodhuesit apo importuesit e ambalazheve që mbushen në vendin e shitjes së produktit.

27. “ppm” (parts për milion), njësi matëse “pjesë për milion”.

28. “Prodhuesit e ambalazheve”, një subjekt tregtar, person, fizik dhe/ose juridik, që prodhon ose importon ambalazhe, duke përfshirë prodhuesit apo importuesit e ambalazheve që mbushen në vendin e shitjes së produktit.

29. “Qese plastike”, ambalazhet plastike që përdoren në pikat e shitjes me shumicë apo pakicë, supermarkete dhe pika shitjeje të zakonshme.

30. “Riciklim”, ka kuptimin që jepet në ligjin nr. 10 463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”.

31. “Riciklim organik”, trajtimi aerobik (kompostim) apo an-aerobik (biometanizim) në kushte të kontrolluara dhe duke përdorur mikroorganizma të pjesëve të biodegradueshme të mbetjeve të ambalazheve, që prodhojnë mbetje organike të stabilizuara apo metan. *Lendfilli* nuk konsiderohet si riciklim organik.

32. “Rikuperim” ka kuptimin që jepet në ligjin nr. 10 463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”.

33. “Rikuperim energjie”, përdorimi i mbetjeve të djegshme të ambalazheve si një mënyrë për të gjeneruar energji, përmes incinerimit të drejtpërdrejtë të tyre, me ose pa praninë e mbetjeve të tjera, por me rikuperim nxehtësie.

34. “Ripërdorim”, ka kuptimin që jepet në ligjin nr. 10 463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”.

35. “Sistem i pagesave të rimbursueshme”, sistemi sipas së cilit blerësi në momentin e blerjes së një produkti të ambalazhuar parapaguan një vlerë të caktuar, e cila, në këmbim të kthimit të një sasive ambalazhi, i rikthehet atij: i) në vlerë monetare; ii) në trajtë të një malli apo produkti tjetër me vlerë të njëjtë me shumën e parapaguar.



36. “Stacion transferimi”, një qendër e autorizuar dhe e specializuar, ku dërgohet përmbajtja e të gjithë koshave të mbetjeve të riciklueshme të thata, të asaj njësie të qeverisjes vendore, për të realizuar ndarjen e mëtejshme e të veçuar sipas rrymave specifike të mbetjeve, si ambalazheve të letrës e kartonit, të plastikës, të qelqit etj.

37. “Shitës”, një person, fizik ose juridik, i cili e shet ose e ofron produktin e pakëtuar te konsumatori.

38. “Trajtimi i mbetjeve nga ambalazhet”, procedura në të cilën, gjatë procesit mekanik, fizik, termik, kimik ose biologjik, përfshirë grumbullimin e diferencuar, karakteristikat e mbetjeve ndryshohen me qëllim që të reduktohet sasia e tyre, duke lehtësuar, në këtë mënyrë, menaxhimin dhe përmirësimin e përdorimit të tyre.

#### IV. PRODHIMI I AMBALAZHEVE

Prodhuesit e materialeve të ambalazheve dhe të ambalazheve e të mallrave të ambalazuara përdorin teknikat më të mira të disponueshme, sipas përcaktimit të bërë për to në ligjin nr. 10 448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit”. Këto teknologji kontribuojnë në:

- a) zvogëlimin e sasisë së mbetjeve të përfutuara nga ambalazhet;
- b) parandalimin dhe pakësimin e materialeve përbërëse të ambalazhit të dëmshme për mjedisin;
- c) shfrytëzimin e ambalazhit duke e ripërdorur, përpunuar, ricikluar dhe duke e rikuperuar atë.

#### V. MASAT PËR PARANDALIMIN E GJENERIMIT TË MBETJEVE NGA AMBALAZHET

1. Operatorët ekonomikë marrin masat e nevojshme për parandalimin e gjenerimit të mbetjeve të ambalazheve, duke përmbushur kriteret e përcaktuara në kreun VI, të këtij vendimi, për kërkesat specifike për ambalazhet.

2. Shitësit përcaktojnë çmimin e ambalazhit të mallrave që ambalazhohen në pikën e tyre të shitjes dhe e pasqyrojnë atë si zë më vete në faturën përkatëse që i lëshojnë blerësit.

3. Prodhuesit e materialeve të ambalazheve dhe të ambalazheve, në zbatim të programeve kombëtare, rajonale e vendore, për parandalimin e mbetjeve, hartojnë programet e tyre specifike për parandalimin e gjenerimit të mbetjeve të ambalazheve.

4. Agjencitë rajonale të mjedisit miratojnë programet e parandalimit të gjenerimit të mbetjeve nga subjektet e përcaktuara në pikën 3, të këtij kreu, duke pasur parasysh sigurimin e zbatimit të parimit të përgjegjësisë mjedisore për çdo operator.

5. Inspektorët rajonalë mjedisorë kontrollojnë zbatimin e programit të parandalimit të mbetjeve të subjekteve të përcaktuara më sipër.

#### VI. KËRKESA THELBËSORE PËR PRODHIMIN DHE PËRBËRJEN E AMBALAZHEVE

1. Prodhuesit e materialeve të ambalazheve prodhojnë dhe hedhin në treg ambalazhe, në përputhje me kërkesat thelbësore të përcaktuara në këtë vendim, përfshirë edhe ato të përcaktuara në shtojcën nr. 2, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ambalazhi konsiderohet në përputhje me kërkesat thelbësore të këtij rregulli teknik kur ai është në përputhje me:

- a) standardet e harmonizuara shqiptare, referenca e të cilave është botuar në Fletoren Zyrtare;
- b) kur nuk ekzistojnë Standardet e Harmonizuara Shqiptare, me standardet e parashikuara në pikën, të këtij kreu.

#### VII. NIVELI I PËRQENDRIMIT TË METALEVE TË RËNDA NË AMBALAZH

1. Prodhuesit e ambalazheve, të materialeve të ambalazheve dhe të mallrave të ambalazuara prodhojnë ambalazhe dhe materiale ambalazhesh apo tregtojnë ambalazhe, me kusht që shuma e niveleve të përqendrimit të plumbit, kadmiumit, merkurit ose kromit heksivalent të pranishëm në ambalazh apo pjesë të ambalazhit, brenda afateve kohore të mëposhtme, sipas shtojcës nr.3, bashkëlidhur këtij vendimi, nuk kapërcen:

- a) gjashtëqind ppm të peshës, deri më 30 qershor 2014;
- b) dyqind e pesëdhjetë ppm të peshës, deri më 30 qershor 2015;
- c) njëqind ppm të peshës, deri më 30 qershor 2017.

2. Kërkesat e pikës 1 të këtij kreu, nuk zbatohen për ambalazhet që përbëhen tërësisht prej qelqit, me kristal prej plumbi.

#### VIII. SISTEMI I SHËNJIMIT DHE IDENTIFIKIMIT TË AMBALAZHEVE

1. Prodhuesi i mallrave të ambalazuara apo ambalazhuesi shënon mbi çdo ambalazh të hedhur në treg:

a) numrin e identifikimit dhe shkurtimin e emërimit të materialeve të ambalazheve sipas shtojcës nr. 4, bashkëlidhur këtij vendimi;

b) shenjën e riciklimit/rikuperimit të ambalazhit sipas shtojcës nr. 4, bashkëlidhur këtij vendimi;

c) shënimin që njofton detyrimin për grumbullim të diferencuar të mbetjeve nga ambalazhet.

2. Subjektet e përcaktuara në pikën 1 të këtij kreu, janë të detyruara që të vendosin shënimin përkatës për materialin e biodegradueshëm sipas shtojcës nr. 4, bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Subjektet e përcaktuara në pikën 1 të këtij kreu, marrin masa, që, brenda muajit janar 2013, të sigurojnë që shënimet mbi ambalazh të jenë të qarta, të lexueshme dhe të qëndrueshme edhe pasi të jetë hapur ambalazhi.

4. Subjektet e përcaktuara në pikën 1 të këtij kreu, duhet t'i vendosin shënimet e sipërpërmendura mbi ambalazh ose mbi markën e tij.

#### IX. RIPËRDORIMI I MBETJEVE TË AMBALAZHEVE

1. Operatorët ekonomikë marrin masa për të nxitur ripërdorimin e ambalazheve, sikurse përcaktohet në kreun XI të këtij vendimi.

2. Operatorët ekonomikë marrin masat e nevojshme dhe i njoftojnë përdoruesit për mundësinë e ripërdorimit të ambalazheve.

#### X. RICIKLIMI DHE RIKUPERIMI

1. Çdo prodhues i mallrave të ambalazuara apo ambalazhues që ushtron veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë do të rikuperojë dhe do të riciklojë minimalisht sasitë e përcaktuara më poshtë të ambalazheve dhe mbetjeve nga ambalazhet, brenda kufijve kohorë, si më poshtë vijon:

a) Jo më vonë se data 30 qershor 2017:

i) rikuperon ose incineron në incineratorë mbetjesh me rikuperim energjie 50-65% të mbetjeve nga ambalazhet e gjeneruara në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ii) riciklon 25-45% të totalit të peshës totale të materialeve që përmbahen në mbetjet e ambalazhit dhe të paktën 15% të peshës për secilin material në veçanti;

b) Jo më vonë se data 31 dhjetor 2019:

i) rikuperon ose incineron në incineratorë mbetjesh me rikuperim energjie 60% të mbetjeve nga ambalazhet;

ii) riciklon 55-80% të peshës së ambalazheve;

iii) riciklon, sipas llojit të materialit të mbetjes së ambalazhit:

- 60% të qelqit;

- 60% të letrës dhe kartonit;

- 50% të metalit;

- 22,5% të plastikës, duke llogaritur vetëm atë që riciklohet përsëri në plastikë;

- 15% të drurit.

2. Objektivat e përcaktuar në pikën 1 të këtij kreu, janë të detyrueshëm për t'u arritur edhe në nivelin e çdo njësie të qeverisjes vendore.

3. Mbetjet e ambalazheve të eksportuara llogariten për efekt të realizimit të objektivave vetëm në bazë të dokumenteve, ku evidentohet se operacionet e rikuperimit dhe/ose riciklimit janë kryer në kushte të ngjashme ose shumë të ngjashme me ato të përcaktuara në legjislacionin e Bashkimit Europian për këtë çështje.

#### XI. SISTEMET E GRUMBULLIMIT, KTHIMIT DHE RIKUPERIMIT

1. Prodhuesi i mallrave të ambalazuara dhe prodhuesi i ambalazheve që mbushen në pikën e shitjes apo persona të tretë që veprojnë në emër të tyre marrin masa që të financojnë të gjitha kostot, që rrjedhin për ngritjen dhe funksionimin e sistemeve të kthimit e rikuperimit të mbetjeve të ambalazheve,



individualisht apo në bashkëpunim ndërmjet tyre, brenda një afati prej 4 (katër) vjetësh nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

2. Përdoruesi shtëpiak dhe josthtëpiak hedh mbetjet e ambalazheve në vendin e treguar për dorëzimin e mbetjeve të ambalazheve nga subjektet e përcaktuara në pikën 1, të këtij kreu, dhe/ose në vendet e përcaktuara nga njësi e qeverisjes vendore përkatëse, bazuar në rregulloren e miratuar prej saj.

3. Subjektet e përcaktuara në pikën 1 të këtij kreu, me qëllim që të ruajnë të pacenuar cilësinë e mbetjeve të ambalazheve që shkojnë për ripërdorim apo riciklim, marrin masat për transportimin me mjete të përshtatshme, në mënyrë të diferencuar, të mbetjeve të ambalazheve dhe, në asnjë rast, nuk lejojnë transportimin e mbetjeve bashkiake të përziera.

4. Subjektet e përcaktuara në pikën 1 të këtij kreu, peshojnë mbetjet e ambalazheve sipas materialit të tyre dhe kryejnë rregullisht regjistrimin e të dhënave në regjistrat e tyre, të krijuara për këtë qëllim.

5. Subjektet e përcaktuara në pikën 1 të këtij kreu, u dorëzojnë subjekteve ricikluese mbetje ambalazhesh të përbëra prej materialeve që ato riciklojnë, kundrejt dorëzimit të formularit 2, siç përshkruhet në shtojcën nr.5, bashkëlidhur këtij vendimi, ku evidentohen të dhëna për ambalazhet e grumbulluara dhe ato të dërguara për përpunim e riciklim.

## XII. MONITORIMI DHE RAPORTIMI

1. Prodhuesi i mallrave të ambalazhuara dhe prodhuesi i ambalazheve që mbushen në pikën e shitjes apo persona të tretë që veprojnë në emër të tyre, brenda datës 31 janar të çdo viti, raportojnë në njësinë e qeverisjes vendore përkatëse të dhënat e regjistruara për vitin paraardhës, në përputhje me kërkesat e pikës 4 të kreut XI të këtij vendimi.

2. Njësitë e qeverisjes vendore llogaritin të dhënat e marra e të regjistruara nga subjektet e përcaktuara në pikën 1 të këtij kreu, për gjithë territorin nën juridiksionin e tyre për vitin kalendarik paraardhës dhe i regjistrojnë ato në regjistrat e tyre, të krijuar për këtë qëllim.

3. Njësitë e qeverisjes vendore raportojnë, brenda datës 28 shkurt të çdo viti në agjenci, shifrat e realizuara të grumbullimit për vitin paraardhës, sipas pikës 4 të kreut XI të këtij vendimi, dhe në total për gjithë territorin nën juridiksionin e tyre.

4. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave raporton, brenda datës 28 shkurt të çdo viti, në agjenci, për importet dhe eksportet e mallrave ambalazh dhe të mallrave të ambalazhuara për vitin paraardhës, në bazë të peshës së tyre.

5. Agjencia llogarit për gjithë territorin e vendit dhe regjistron në regjistrat e saj, të krijuar për këtë qëllim:

- a) peshën e përgjithshme të mbetjeve të ambalazheve të grumbulluara në mënyrë të diferencuar;
- b) peshën e përgjithshme të mbetjeve të ambalazheve sipas llojit të materialit përbërës.

6. Agjencia i përfshin rezultatet e përqindjeve të grumbullimit të mbetjeve të ambalazheve në raportet e gjendjes së mjedisit.

7. Agjencia krijon, administron dhe përditëson një sistem *database* për ambalazhet dhe mbetjet e tyre, duke marrë në konsideratë, por pa u kufizuar, në të dhënat e tabelave 1 dhe 2 në shtojcën nr. 6, bashkëlidhur këtij vendimi.

8. Sistemi i regjistrimit *database*, përveç të tjerave, jep informacion për përmasat, karakteristikat dhe evolucionin e rrymave të ambalazheve dhe mbetjeve të tyre, toksicitetin apo rrezikun e materialeve të ambalazhit dhe të përbërësve nga të cilat është prodhuar.

9. Ministria i vendos rezultatet e këtij regjistrimi e monitorimi në dispozicion të publikut, bazuar në nenin 60 të ligjit nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”.

## XIII. INFORMIMI I PËRDORUESVE TË AMBALAZHEVE

Ministria, njësitë e qeverisjes vendore dhe operatorët ekonomikë marrin masat e nevojshme, që, brenda 1 (një) viti nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të njoftojnë përdoruesit dhe, në mënyrë të veçantë, konsumatorët për:

a) sistemet e kthimit, grumbullimit dhe rikuperimit që janë në dispozicion të tyre për mbetjet nga ambalazhet;

- b) pagesën që bën blerësi për ambalazhet që mbushen në pikën e shitjes;
- c) rolin dhe kontributin e tyre në grumbullimin e diferencuar, në ripërdorimin, rikuperimin dhe riciklimin e ambalazheve dhe mbetjeve të tyre;
- ç) kuptimin e shenjave mbi ambalazhet që janë hedhur në treg;
- d) rëndësinë e përmbushjes dhe elementet përbërëse të planit kombëtar, rajonal e lokal të menaxhimit të ambalazheve dhe mbetjeve të tyre.

#### XIV. INSTRUMENTET EKONOMIKE

1. Përdoruesit e ambalazheve dhe mallrave të ambalazuara, si dhe prodhuesit dhe/ose palët e treta që veprojnë në emër të tyre përdorin instrumente ekonomike që nxitin zbatimin e kërkesave të këtij vendimi (si taksa produkti, taksa të diferencuara etj.), duke marrë në konsideratë parashikimet e bëra në ligjin nr. 10 463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, apo mbështetur në akte të tjera, ligjore e nënligjore.

2. Prodhuesit e ambalazheve, të mallrave të ambalazuara e të materialeve të ambalazheve dhe persona të tretë, që veprojnë në emër të tyre, përdorin instrumente ekonomike (sisteme të rimbursimit të pagesave etj.), që nxitin:

- a) grumbullimin e mbetjeve të ambalazheve;
- b) përdorimin e materialeve ambalazhuese që nuk përmbajnë substanca të rrezikshme.

#### XV. NDALIME

1. Ndalohen prodhimi, importimi dhe hedhja në treg e ambalazheve kur nuk respektohen nga subjektet përgjegjëse kërkesat për nivelet e përqendrimit të metaleve të rënda në ambalazhe, të përcaktuara në kreun VII të këtij vendimi.

2. Ndalohen prodhimi, importimi dhe hedhja në treg e qeseve plastike nën  $30\mu$  (mikro) (15 për çdo anë).

3. Mbas datës 1 shtator 2012 ndalohen prodhimi dhe hedhja në treg e qeseve plastike të pabiodegradueshme nga të gjithë operatorët ekonomikë.

4. Mbas datës 1 shtator 2012 ndalohet importimi i qeseve të plastikës të pabiodegradueshme.

5. Mbas datës 1 janar 2013 ndalohen përdorimi dhe tregtimi i qeseve plastike të pabiodegradueshme nga të gjitha njësitë tregtare.

6. Ndalohet transporti i mbetjeve të ambalazheve me mjetet që transportojnë mbetje organike të përziera shtëpiake/bashkiake.

#### DISPOZITA TË FUNDIT

#### XVI. ORGANET PËRGJEGJËSE DHE AKTE TË MINISTRIT PËRGJEGJËS PËR MJEDISIN

Ngarkohen Ministria, Inspektorati Qendror Teknik, në varësi të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, njësitë e qeverisjes vendore dhe të gjithë operatorët ekonomikë e subjektet e përcaktuara në këtë vendim për zbatimin e këtij vendimi.

#### XVII. SANKSIONET

Shkelja e parashikimeve të këtij vendimi, kur ato nuk përbëjnë vepër penale, i nënshtrohet sanksioneve të përcaktuara në nenin 62 të ligjit nr. 10 463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, si dhe sanksioneve të tjera, të parashikuara nga dispozitat ligjore përkatëse.

#### XVIII. SHTOJCAT

Shtojcat bashkëlidhur këtij vendimi janë pjesë përbërëse e tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha





## SHTOJCA NR. 1 SHEMBUJ ILUSTRUES PËR KRITERET E PËRMENDURA NË PIKËN 1 TË PËRKUFIZIMEVE

### 1. Shembuj ilustrues për kriterin 1.1

Ambalazh: Kuti ëmbëlsirash; mbështjellësja me një fletë të hollë metalike e një kutie CD.

Joambalazh: Vazo lulesh të projektuara për të qëndruar me bimën gjatë gjithë ciklit të jetës së tyre; kuti veglash; qese/paketa çaji; shtresat e dyllit përreth djathit; lëkurat e sallameve.

### 2. Shembuj ilustrues për kriterin 1.2

Ambalazhe nëse janë projektuar dhe synuar që të mbushen në pikën e shitjes:

Qese mbajtëse prej letre ose plastike; pjata dhe gota njëpërdorimshme; qese mbështjellëse plastike; qese sanduiçësh; mbështjellëse alumini; përzierës; lugë, pirunë e thika njëpërdorimshme

### 3. Shembuj ilustrues për kriterin 1.3

Ambalazhe: Etiketa që vendosen drejtpërsëdrejti ose ngjiten te produkti

Pjesë e ambalazhit; furça rimelesh që përbëjnë pjesë të rimelit; kapëse letrash; doreza plastike; pajisje për matjen e dozave që janë të përfshirë në pluhurat larës.

## SHTOJCA NR. 2 KËRKESAT THEMELORE PËR PËRBËRJEN, RIPËRDORIMIN DHE RIKUPERIMIN, PËRFSHIRË RICIKLIMIN E AMBALAZHEVE

### 1. Kërkesa specifike për prodhimin dhe përbërjen e ambalazheve

- Ambalazhet do të prodhohen në mënyrë të tillë që volumi i ambalazhit dhe pesha e tij të kufizohet në masën minimale të mundshme që njëkohësisht siguron nivelin e nevojshëm të sigurisë, higjienës dhe pranueshmërisë, si për produktin e ambalazhuar ashtu edhe për konsumatorin.

- Ambalazhet do të projektohen, prodhohen dhe tregtohen në mënyrë të tillë që të lejojnë ripërdorimin ose rikuperimin e tij, duke përfshirë riciklimin, dhe të minimizojnë ndikimin në mjedis të mbetjeve të ambalazheve gjatë menaxhimit apo çka tepron prej këtyre operacioneve gjatë asgjësimit të tyre.

- Ambalazhet duhet të prodhohen, në mënyrë të tillë që prania e substancave të dëmshme dhe substancave dhe materialeve të tjera të rrezikshme, si përbërës të materialit të ambalazheve apo të ndonjë prej përbërësve të ambalazheve, të minimizohet për sa i përket pranisë së tyre në shkarkimet në ajër, hirin, apo lëngjet e kullimit kur ambalazhet apo mbetjet e tyre pas operacioneve të tjera të menaxhimit incinerohen apo asgjësohen në *landfill*.

### 2. Kërkesat specifike sipas natyrës së ripërdorimit të ambalazheve

Njëkohësisht duhet të plotësohen edhe kërkesat e mëposhtme:

- Veçoritë dhe karakteristikat fizike të ambalazheve duhet të bëjnë të mundur realizimin e një numri udhëtimesh apo rrotullimesh në kushte përdorimi normalisht të parashikueshme.

- Mundësia për përpunimin e ambalazheve të përdorura me qëllim që të përmbushen kërkesat për shëndetin dhe sigurinë e fuqisë punëtore.

- Plotësimin e kërkesave specifike për rikuperimin e ambalazheve kur ambalazhet nuk ripërdoren më dhe kthehen në mbetje.

### 3. Kërkesat specifike sipas natyrës së rikuperueshmërisë së ambalazheve

#### a) Ambalazhi i rikuperueshëm në formën e riciklimit të materialeve

Ambalazhi duhet të prodhohet në mënyrë të tillë që të mundësojë riciklimin e një përqindjeje të caktuar të peshës së materialeve të përdorura për prodhimin e produkteve të tregëtueshme, në përputhje me standardet aktuale në fuqi në Komunitetin Europian. Vendosja e kësaj përqindjeje mund të ndryshojë në varësi të llojit të materialit prej të cilit është përbërë ambalazhi.

#### b) Rikuperimi në formën e rikuperimit të energjisë

Mbetjet e ambalazheve të përpunuara me qëllim rikuperimin e energjisë do të kenë një vlerë minimale kalorike të caktuar në mënyrë që të mundësojnë optimizimin e rikuperimit të energjisë.

c) Ambalazhe të rikuperueshme në formën e kompostimit

Mbetjet e ambalazheve që përpunohen në formën e kompostimit do të jenë të një natyre të tillë të biodegradueshme që të mos pengojnë grumbullimin e diferencuar dhe procesin ose aktivitetin e kompostimit.

d) Ambalazhe të biodegradueshme

Mbetjet nga ambalazhet e biodegradueshme duhet të jenë të një natyre të tillë që të përballojnë zbrërthimet fizike, kimike, termike ose biologjike, në mënyrë që pjesa më e madhe e masës së formuar në fund, të dekompozohet në dioksid karboni, biomasë dhe ujë.

SHTOJCA NR. 3  
DEKLARATAT E PËRPUTHSHMËRISË

DEKLARATA E PËRPUTHSHMËRISË

Me kërkesat e seksionit VII “Niveli i përqendrimit të metaleve të rënda në ambalazh” të vendimit të Këshillit të Ministrave nr..... datë ..... “Për ambalazhet dhe mbetjet nga ambalazhet.

Nr ..... , datë .....

Prodhuesi/importuesi i ambalazheve/ materialeve të ambalazheve: .....

(emërtimi i kompanisë/ emri i subjektit tregtar, nr. NIPT-i)

Përfaqësuar nga:.....

(emri dhe mbiemri, funksioni)

Të dhënat e kompanisë/ subjektit tregtar:.....

(adresa e selisë/ objekti i aktivitetit tregtar, telefon, fax etj. )

DEKLAROJ SE:

1. Ambalazhi/ materiali i ambalazhit : .....

(identifikimi i sasisë dhe materialit të ambalazhit)

I përgjigjet kërkesave të seksionit VII “Niveli i përqendrimit të metaleve të rënda në ambalazh” të vendimit të Këshillit të Ministrave nr..... datë..... “Për ambalazhet dhe mbetjet nga ambalazhet”.

2. Ambalazhi/ materiali i ambalazhit është prodhuar në përputhje me;.....

(identifikimi i standardit përkatës shqiptar)

Unë deklaroj se jam i ndërgjegjshëm për përgjegjësinë time në lidhje me ligjin “Për menaxhimin e mbetjeve”.

.....

(vendi dhe data e lëshimit)

(firma dhe vula e prodhuesit, importuesit )



## DEKLARATË PËRPUTHSHMËRIE

Me kërkesat e seksionit VI “Kërkesa specifike për prodhimin dhe përbërjen e ambalazheve” të vendimit të Këshillit të Ministrave nr..... datë ..... “Për ambalazhet dhe mbetjet nga ambalazhet”

Nr. .... datë. ....

Prodhuesi/importuesi i materialeve të ambalazheve/ ambalazheve; .....  
(emërtimi i kompanisë/ emri i subjektit tregtar, nr. NIPT-i)

Përfaqësuar nga;.....  
(emri dhe mbiemri, funksioni)

Të dhënat e kompanisë/ subjektit tregtar;.....  
(adresa e selisë/ aktivitetit tregtar, telefon, fax etj. )

### DEKLAROJ SE:

1. Ambalazhi/materiali i ambalazhit:.....  
(identifikimi i sasisë dhe materialit të ambalazhit)

I përgjigjet kërkesave të seksionit III “Kërkesa specifike për prodhimin dhe përbërjen e ambalazheve” të vendimit të Këshillit të Ministrave nr..... datë..... “Për ambalazhet dhe mbetjet nga ambalazhet”.

2. Ambalazhi/ materiali i ambalazhit është ekzaminuar në .....  
(emrin dhe adresën e laboratorit ekzaminues të akredituar, të dhënat e dokumentit, datë, nr. prot. etj. )

Unë deklaroj se jam i ndërgjegjshëm për përgjegjësinë time në lidhje me ligjin “Për menaxhimin e mbetjeve”.

.....  
(vendi dhe data e lëshimit)

.....  
(firma dhe vula e prodhuesit, importuesit )

SHTOJCA NR. 4  
SISTEMI I IDENTIFIKIMIT TË AMBALAZHEVE

Identifikimi i materialeve të ambalazhit bëhet sipas një sistemi numrash dhe/ose shkurtimeve të mëposhtme. Këto shkurtime vendosen mbi ambalazh. Përdorimi i numrave dhe shkurtimeve të tjera për identifikimin e të njëjtave materiale nuk lejohet.

Numrat:

- 1-9 i takojnë plastikës;
- 20-30 i takojnë letrës dhe kartonit;
- 40-49 i takojnë metalit;
- 50-59 i takojnë drurit;
- 60-69 i takojnë tekstileve; dhe
- 70-79 i takojnë qelqit.

Shkurtime bëhen me shkronja kapitale, p.sh.:

a) Disa shembuj për shkurtime dhe numra për plastikën

- Polietilen tereftalat: PET;
- Polietilen me dendësi të lartë: HDPE, 2;
- Klor polivinil: PVC, 3;
- Polietilen me dendësi të ulët: LDPE, 4;
- Polipropilen: PP, 5;
- Polistiren: PS, 6.

b) Shkurtime dhe numra për letrën dhe pllakën e presuar

- Pllakë e presuar e valëzuar: PAP, 20;
- Pllakë e presuar jo e valëzuar: PAP, 21;
- Letër: PAP, 22.

c) Shkurtime dhe numra për metalet

- Çeliku: FE, 40;
- Alumini: ALU, 41.

d) Shkurtime dhe numra për materialet e drurit

- Druri: FOR, 50;
- Tapa: FOR, 51.

e) Shkurtime dhe numra për materialet tekstile

- Pambuku: TEX, 60;
- Fibra copash(Jute): TEX, 61.

f) Shkurtime dhe numra për qelqin

- Qelq pa ngjyrë: GL, 70;
- Qelq jeshil: GL, 71;
- Qelq kaf GL, 72.

g) Shkurtime dhe numra për materialet e përbëra

- Për lëndët e përbëra C/ plus shkurtimeve të materialit dominues;
- Letër dhe pllakë e presuar/metale të tjera: 80;
- Letër dhe pllakë e presuar/plastika: 81;
- Letër dhe pllakë e presuar/alumini: 82;
- Letër dhe pllakë e presuar/teneqe: 83;
- Letër dhe pllakë e presuar/plastika/alumini: 84;
- Letër dhe pllakë e presuar/plastika/teneqe: 85;
- Plastika/alumini: 90;
- Plastika/teneqe: 91;
- Plastika/metale të tjera: 92;
- Qelq/plastikë: 95;



- Qelq/alumin: 96;
- Qelq/teneqe: 97;
- Qelq/metale të tjera: 98.

Shenja për riciklueshmërinë/rikuperueshmërinë e ambalazhit dhe llojin e materialit nga i cili është prodhuar.



Shenja për evidentimin e materialit ambalazhues i cili është i biodegradueshëm



Shenjat e identifikimit të materialit shënohen në qendër ose poshtë shenjës grafike që tregon riciklueshmërinë apo rikuperueshmërinë e ambalazhit apo që përbëhet nga material i biodegradueshëm.

SHTOJCA NR. 5  
FORMULARI 1

1. Të dhënat për ambalazhin e hedhur në treg: _____ datë					
2. Të dhënat për prodhuesin/ambalazhuesin			Kompania:		
			Personi i Kontaktit:		
			Tel/Fax:		
			Adresa:		
Numri unik i identifikimit të kompanisë tregtare (NIPT)					
3. Të dhënat për llojin dhe sasinë e ambalazhit që është hedhur në treg					
Lloji i materialit të ambalazhit	Përmbajtja e metaleve të rënda mg/kg	Sasia e hedhur në treg (kg)	Sasia e ambalazhit të hedhur në treg -njësia e ambalazhit (copë)	Sasia e ambalazhit të: eksportuar - importuar	
1. Qelq					
2. Metal					
3. Letër-karton dhe ambalazh shumështrësor i përbërë prej letre					
4. Plastikë					
5. Dru					
6. Ambalazh prej materialeve të tjera					
4. Personi përgjegjës për të dhënat:					

Formulari 2

5. Të dhënat për ambalazhin e grumbulluar dhe çuar në përpunim, riciklim Raportimi për vitin _____ Ambalazhi i hedhuri në treg: _____ datë					
6. Të dhënat për prodhuesin/ambalazhuesin			Kompania:		
			Personi i kontaktit:		
			Tel/Fax:		
			Adresa:		
Numri unik i identifikimit të kompanisë tregtare (NIPT)					
7. Të dhënat për llojin dhe sasinë e ambalazhit					
		Sasia e dorëzuar te përpunuesi (kg)			
Lloji i materialit të ambalazhit	Sasia e përgjithshme e grumbulluar (kg)	Sasia për riciklim (kg)	Sasia për mënyra të tjera të përpunimit (kg)	Sasia e eksportuar	Përpunuesi
7. Qelq					
8. Metal					
9. Letër-karton dhe ambalazh shumështrësor i përbërë prej letre					
10. Plastikë					
11. Dru					
12. Ambalazh prej materialeve të tjera					
11. Dokumentacion bashkëlidhur që provon vërtetësinë e të dhënave :					
12. Personi përgjegjës për të dhënat:					

**SHTOJCA 6**  
**RAPORTI PËRMBLEDHËS PËR AMBALAZHET DHE MBETJET NGA AMBALAZHET E RIPËRPUNUARA**

Tabela 1

Sasitë e mbetjeve nga ambalazhet që gjenerohen në Republikën e Shqipërisë dhe që janë rikuperuar apo incineruar me rikuperim energjie brenda ose jashtë Shqipërisë

Materiali	Mbetjet e gjeneruara	Të rikuperuara ose incineruara me rikuperim energjie nga:					Incinerim me rikuperi energjie
		Riciklim i materialit	Forma të tjera riciklimi	Riciklim total	Rikuperimi i energjisë	Forma të tjera rikuperim	
	(a)	(b)	(c)	(d)	(e)	(f)	(g)
Qelq							
Plastika							
Letra dhe dërrasa							



Metali	Alumin						
	Çelik						
	Totali						
Druri							
Të tjera Total							

#### Shënime

1. Kutitë e bardha: Sigurimi i të dhënave është i detyrueshëm. Llogaritjet mund të përdoren pavarësisht se ato mund të jenë bazuar në të dhëna empirike dhe të jenë shpjeguar në përshkrimin e metodologjisë.
2. Kutitë me ngjyrë të verdhë: Sigurimi i të dhënave është i detyrueshëm, por edhe të dhënat e përafërta janë të pranueshme. Këto llogaritje duhet të shpjegohen në përshkrimin e metodologjisë.
3. Kutitë me ngjyrë jeshile: Sigurimi i të dhënave është vullnetar.
4. Për qëllimin e këtij vendimi, të dhënat për riciklimin e materialeve për plastikën duhet të përfshijnë të gjithë materialin e ricikluar prapë në plastikë.
5. Kolona “c” përfshin të gjitha format e riciklimit duke përfshirë dhe riciklimin organik, por duke përjashtuar riciklimin material.
6. Kolona “d” është shuma e kolonave “b” dhe “c”.
7. Kolona “f” përfshin të gjitha format e rikuperimit duke përjashtuar riciklimin dhe rikuperimin e energjisë.

TABELA 2  
SASITË E MBETJEVE NGA AMBALAZHET TË EKSPORTUARA PËR RIKUPERIM OSE  
INCINERIM ME RIKUPERIM ENERGJIE

Materiali	Mbetjet nga ambalazhet që janë eksportuar në shtetet e tjera anëtare ose jashtë komunitetit për:				
	Riciklimi	Forma të tjera të riciklimi	Rikuperim energjie	Forma të tjera të rikuperimi	Incinerim me rikuperim energjie
Qelq					
Plastika					
Letra dhe dërrasa					
Metali	Alumini				
	Çeliku				
	Totali				
Druri					
Të tjera					
Totali					

Shënime

1. Të dhënat në këtë tabelë i referohen vetëm sasive që llogariten sipas detyrimeve të këtij vendimi për objektivat. Ato janë një nënbashkësi e të dhënave që jepen në tabelën 1.
2. Kjo tabelë është vetëm për qëllime informimi.
3. Kutitë me ngjyrë të bardhë: Sigurimi i të dhënave është i detyrueshëm, por pranohen dhe llogaritje të përafërta. Këto llogaritje duhet të shpjegohen në përshkrimin e metodologjisë.
4. Kutitë me ngjyra jeshile: Sigurimi i të dhënave është vullnetar.
5. Për qëllimin e këtij vendimi, të dhënat për riciklimin material për plastikën duhet të përfshijnë të gjithë materialin e ricikluar prapë në plastikë.

**VENDIM**

**Nr. 178, datë 6.3.2012**

**PËR INCINERIMIN E MBETJEVE\***

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 47 të ligjit nr. 10 463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**I. QËLLIMI**

Qëllimi i këtij vendimi është përcaktimi i kërkesave të detajuara për incinerimin dhe bashkincinerimin e mbetjeve, duke synuar parandalimin ose kufizimin sa më shumë të jetë e mundur të efekteve negative në mjedis dhe rreziqeve që rezultojnë, për shëndetin e njeriut, nga ndotja e shkaktuar nga shkarkimet prej këtyre proceseve në ajër, tokë, ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore.

**II. PËRKUFIZIME**

Në kuptim të këtij vendimi, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Mbetje bashkiake të përziera”, mbetjet me origjinë nga shtëpitë dhe mbetjet e sektorit të tregtisë, industrisë dhe të institucioneve, të cilat, për shkak të natyrës dhe përbërjes së tyre janë të ngjashme me mbetjet me origjinë familjare, por duke përjashtuar fraksionet e treguara në aneksin 1 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 99, datë 18.2.2005 “Për miratimin e Katalogut Shqiptar për Klasifikimin e Mbetjeve”, nën titullin 20 01, të cilat grumbullohen veçmas në burim, dhe duke përjashtuar mbetjet e tjera që paraqiten nën titullin 20 02, të po atij aneksi;

2. “Impiant ekzistues incinerimi apo bashkincinerimi”, një impiant incinerimi apo bashkincinerimi:

a) i cili ka qenë në punë në datën që ka hyrë në fuqi, ligji nr. 10 448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit”; ose

b) i cili nuk ka qenë në punë në datën që ka hyrë në fuqi ligji nr. 10 448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit”, por të cilit i është dhënë leja e ndërtimit në përputhje me ligjin nr. 10 119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, me kusht që ndërtimi i impiantit të fillojë brenda një viti nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

3. “Kapacitet nominal”, shuma e kapaciteteve të bashkincinerimit të furrave prej të cilave përbëhet impianti i bashkincinerimit, ashtu siç specifikohet nga ndërtuesi dhe konfirmohet nga operatori, duke marrë parasysh, në veçanti, vlerën kalorifike të mbetjeve, të shprehur në sasinë e mbetjeve të incineruara në orë.

\* Ky vendim transponon Direktivën 32000L0076, Direktiva 2000/76/EC për incinerimin e mbetjeve, **OJ L 332, 28.12.2000, p. 91-111**





4. “Dioksinat dhe furanet” janë të gjitha dioksinat dibenzo-p poliklorinuara, si edhe dibenzofuranet e listuara në aneksin I të këtij vendimi.

5. “Leje mjedisi” ka kuptimin e dhënë në ligjin nr. 10 448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit”, e lëshuar në përputhje me kërkesat dhe kushtet e parashtruara në përmbushje të të gjitha kërkesave të këtij vendimi.

6. “Teprica”, çdo material i lëngshëm apo i ngurtë (duke përfshirë edhe hirin që mbetet në fund dhe skoriet, hirin fluturues dhe pluhurin e kaldajës, produktet e ngurta të reaksioneve nga trajtimi i gazrave, llumrat e ujërave të zeza nga trajtimi i ujërave të ndotura, katalizatorët e konsumuar dhe karbonin e aktivizuar të konsumuar), që gjenerohet nga procesi i incinerimit ose bashkincinerimit, nga trajtimi i gazrave të shkarkimit apo ujërave të ndotura ose nga procese të tjera brenda impiantit të incinerimit apo të bashkincinerimit, pra teprica mbetjesh që rezultojnë nga procesi i asgjësimit të mbetjeve.

7. “Shkarkim” ka kuptimin e dhënë sipas ligjit nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”.

8. “Vlerë kufi e shkarkimit” ka kuptimin e dhënë sipas ligjit nr. 10 448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit”.

9. “Ujëra të ndotura” ka kuptimin e dhënë në pikat 1, 2 dhe 3, të nenit 3, të ligjit nr. 9115, datë 24.7.2003 “Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura”, dhe çdo ujë tjetër i ndotur që i nënshtrohet rregulloreve sipas legjislacioneve të tjera, për shkak të substancave apo objekteve që përmban.

10. “Publik” ka kuptimin e dhënë sipas ligjit nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”.

11. “Ministër” është ministri përgjegjës për mbrojtjen e mjedisit.

12. “Mbetje e rrezikshme” ka kuptimin që i është dhënë nga ligji nr. 10 463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”. Kërkesat specifike, të këtij vendimi, për mbetjet e rrezikshme nuk zbatohen për mbetjet e rrezikshme të mëposhtme:

a) mbetjet e lëngshme të djegshme, duke përfshirë vajrat e përdorur që gjenerohen brenda territorit të Republikës së Shqipërisë dhe që nuk përmbajnë PCB, PCT në përqendrim më shumë se 50 pmm, ashtu siç përcaktohet në ligjin “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, me kusht që ato të plotësojnë edhe kriteret e mëposhtme:

i) përmbajtja masive e hidrokarbureve aromatike të poliklorinuara arrin përqendrimet që nuk janë më të larta se ato të përcaktuara në akte të tjera;

ii) këto mbetje nuk konsiderohen si të rrezikshme, në sajë të përmbajtjes së përbërësve të tjerë në sasi ose përqendrimet, dhe që nuk janë në përputhje me kërkesat e nenit 5, të ligjit nr. 10 463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, në mbrojtje të shëndetit të njeriut dhe mjedisit; dhe

iii) vlera kalorifike neto arrin të paktën 30 MJ për kilogram.

b) të gjitha mbetjet e lëngshme të djegshme, të cilat, në gazrat e oxhakat që rezultojnë drejtpërdrejt nga djegia e tyre, nuk mund të shkaktojnë shkarkime të tjera përveç atyre nga gazoili, siç parashikohet në akte të tjera, ose përqendrim më të lartë të shkarkimeve sesa të atyre që rezultojnë nga djegia e gazoilit.

Të gjithë termat e tjerë të përdorur në këtë vendim kanë të njëjtin kuptim të dhënë nga neni 3, i ligjit “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”.

### III. FUSHA E VEPRIMIT DHE PËRJASHTIMET NGA FUSHA E ZBATIMIT TË KËTIJ VENDIMI

1. Ky vendim mbulon të gjitha impiantet e incinerimit dhe bashkincinerimit.

2. Përfshihen nga fusha e zbatimit:

a) Impiantet që trajtojnë vetëm mbetjet e mëposhtme:

i) mbetjet vegjetale nga bujqësia dhe pyjet;

ii) mbetjet vegjetale nga industria e përpunimit të ushqimeve, nëse nxehtësia e gjeneruar rikuperohet;

iii) mbetjet vegjetale me fibra nga prodhimi i brumit (tulit) të paprekur, si edhe nga prodhimi i letrës nga brumi, nëse ato bashkincinerohen në vendin e prodhimit dhe nxehtësia e gjeneruar rikuperohet;

iv) mbetjet drusore, me përjashtim të atyre që mund të përmbajnë përbërje organike halogjene apo metale të rënda, si rezultat i trajtimit me konservantë apo veshje drusore, dhe që përfshin në veçanti të tilla mbetje drusore që e kanë origjinën nga mbetjet e ndërtimit dhe shembjeve;

v) mbetjet e tapave;

vi) mbetjet radioaktive;

vii) skeletet e kafshëve, siç përcaktohet nga legjislacioni përkatës për shëndetin e kafshëve;

viii) mbetjet që rezultojnë nga eksplorimi dhe nga shfrytëzimi i burimeve të naftës dhe gazit nga impiantet detare dhe që digjen në bordin e këtyre impianteve.

b) Impiantet eksperimentale që përdoren për kërkim, zhvillim dhe testim, me qëllim përmirësimin e procesit të incinerimit dhe që trajtojnë më pak se 50 tonë mbetje në vit.

#### IV. KUSHTET E PËRGGJITHSHME QË DUHET TË PLOTËSOJË KËRKESA PËR LEJE MJEDISI

1. Pavarësisht nga dispozitat e ligjit “Për lejet e mjedisit”, kërkesa për leje mjedisi për të operuar një impiant incinerimi ose bashkincinerimi duhet të përfshijë një përshkrim të masave të cilat garantojnë që:

a) impianti është projektuar, është pajisur dhe do të operohet në mënyrë të tillë që kërkesat e këtij vendimi marrin parasysh kategoritë e mbetjeve që do të incinerohen;

b) nxehtësia e gjeneruar gjatë procesit të incinerimit dhe bashkincinerimit do të rikuperohet sa më shumë të jetë e mundur, p.sh., nëpërmjet nxehtësisë dhe fuqisë së kombinuar, gjenerimit të avullit nga procesi apo sigurimit të ngrohjes për banesat e asaj zone;

c) mbetjet do të minimizohen në sasi dhe rrezikshmëri e, atje ku është e mundur, do të riciklohen;

ç) asgjësimi i mbetjeve që nuk mund të parandalohen, reduktohen apo riciklohen do të kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi;

d) impianti është projektuar, ndërtuar, pajisur dhe do të operojë në mënyrë të tillë që të parandalojë shkarkimet në ajër të cilat shkaktojnë rritje të konsiderueshme të nivelit bazë të ndotjes së ajrit, në veçanti gazrat e shkarkimit do të shkarkohen, në mënyrë të kontrolluar dhe në përputhje me legjislacionin përkatës për normat e cilësisë së ajrit, nëpërmjet një oxhaku, lartësia e të cilit është llogaritur në mënyrë të tillë që të ruajë shëndetin e njerëzve dhe mjedisin;

dh) mbetjet spitalore infektive do të vendosen drejtpërdrejt në furrë, pa u përzier më parë me kategori të tjera mbetjesh dhe pa u prekur drejtpërdrejt;

e) menaxhimi i impiantit të incinerimit ose bashkincinerimit do të jetë në dorë të personit fizik që është kompetent të menaxhojë impiantin.

2. Agjencia e Mjedisit dhe e Pyjeve përgatit lejen e mjedisit për operimin e impiantit të incinerimit ose bashkincinerimit vetëm në qoftë se kërkesa e bërë për këtë qëllim tregon se teknikat e propozuara të matjeve për shkarkimet në ajër janë në përputhje me aneksin III, të këtij vendimi dhe, ato në lidhje me shkarkimet në ujë, janë në përputhje me pikat 1 dhe 2 të aneksit III, të këtij vendimi.

#### V. KUSHTET QË DUHET TË PËRFSHIHEN NË NJË LEJE MJEDISI PËR OPERIMIN E NJË IMPIANTI INCINERIMI OSE BASHKINCINERIMI

1. Pavarësisht nga sa është parashikuar në ligjin “Për lejet e mjedisit”, leja e mjedisit të dhënë për operimin e një impianti incinerimi ose bashkincinerimi, përveç përmbushjes së kushteve të zbatueshme, të parashtruara në ligjin “Për lejet e mjedisit”, në aktet normative për trajtimin e ujërave të ndotura, për cilësinë e ajrit të mjedisit, për ndotjen e shkaktuar nga substancat e rrezikshme të shkarkuara në mjedisin ujqor dhe për asgjësimin e mbetjeve në *lendfill*, duhet të përfshijë, gjithashtu, edhe informacionin dhe kërkesat e mëposhtme:



a) Të rendisë qartë kategoritë e mbetjeve që mund të trajtohen. Lista duhet të përdorë, të paktën, kategoritë e mbetjeve të përcaktuara në Katalogun Shqiptar të Mbetjeve, siç përcaktohet në vendimin nr. 99, datë 18.2.2005 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e katalogut për klasifikimin e mbetjeve”, dhe të përmbajë informacion në lidhje me sasinë e mbetjeve, atje ku është e përshtatshme;

b) Të përfshijë kapacitetin total të impiantit të incinerimit apo bashkincinerimit të mbetjeve;

c) Të specifikojë procedurat e marrjes së mostrave dhe të matjes që përdoren për të përmbushur detyrimet e vendosura për matjet periodike të ndotësve të ajrit dhe ujit.

2. Leja e mjedisit që jepet për operimin e një impianti incinerimi apo bashkincinerimi i cili përdor mbetje të rrezikshme, përveç kushteve të parashtruara në kreu VII të këtij vendimi, duhet të përfshijë edhe informacionin dhe kërkesat e mëposhtme:

a) Të rendisë sasinë e kategorive të ndryshme të mbetjeve të rrezikshme që mund të trajtohen;

b) Të specifikojë fluksin maksimal dhe minimal të masës së atyre mbetjeve të rrezikshme, vlerat e tyre kalorifike maksimale e minimale, si dhe përmbajtjen maksimale të ndotësve në to, p.sh., të PCBs, PCPs, klorit, fluorit, squfurit, metaleve të rënda.

#### VI. KUSHTET E PËRGJITHSHME OPERATIVE QË DUHET TË PËRFSHIHEN NË LEJEN E MJEDISIT

1. Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve duhet të sigurojë që leja e mjedisit për operimin e një impianti incinerimi të përfshijë kushtet e mëposhtme:

a) Impiantet e incinerimit duhet të operohen me qëllim që të arrihet një nivel i tillë incinerimi që përmbajtja e karbonit organik total (TOC) të hirit dhe skorjeve që mbeten në fund të jetë më pak se 3% ose që humbja e tyre gjatë ndezjes të jetë më pak se 5% e peshës së thatë të materialit. Nëse është e nevojshme, duhet të përdoren teknikat e duhura të paratrajtimit të mbetjeve.

b) Impiantet e incinerimit duhet të projektohen, pajisen dhe operohen në mënyrë të tillë që temperatura e gazrave që rezultojnë nga procesi, e matur pranë murit të brendshëm apo pranë një pike tjetër përfaqësuese të dhomës së djegies, pasi të jetë autorizuar nga Agjencia e Mjedisit dhe e Pyjeve, të ngrihet në mënyrë të kontrolluar e të njëtrajtshme dhe, madje, edhe në kushtet më të pafavorshme, deri në temperaturën 850° C, për dy sekonda, pas injektimit të fundit të ajrit të djegies. Në qoftë se incinerohen mbetje të rrezikshme me përmbajtje prej më shumë se 1% substanca organike të halogjenuara, të shprehura si klor, temperatura duhet të ngrihet deri në 1100°C për, të paktën, dy sekonda.

c) Çdo linjë e impiantit të incinerimit duhet të pajiset me, të paktën, një pajisje djegëse ndihmëse. Kjo pajisje djegëse duhet të ndizet automatikisht kur temperatura e gazrave të djegies, pas injeksionit të fundit të ajrit të djegies, bie nën 850°C ose 1100°C, sipas rastit. Ajo duhet të përdoret, gjithashtu, edhe gjatë operacioneve të fillimit dhe të mbylljes, me qëllim që temperaturat prej 850°C ose 1100°C, sipas rastit, të ruhen gjatë gjithë kohës së këtyre operacioneve, për sa kohë që mbetjet e padjegura ndodhen në dhomën e djegies.

ç) Gjatë operacioneve të fillimit dhe mbylljes ose kur temperatura e gazit të djegies bie nën 850° C ose 1100°C, sipas rastit, pajisja djegëse ndihmëse nuk duhet të ushqehet me lëndë djegëse të tilla që mund të shkaktojnë shkarkime më të larta sesa ato që rezultojnë nga djegia e gazoilit, gazrave të lëngëzuara apo gazit natyror.

2. Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve duhet të sigurojë që leja e mjedisit për operimin e një impianti me bashkincinerim do të përmbajë kushte që sigurojnë se impiantet e bashkincinerimit të projektohen, pajisen, ndërtohen dhe operohen në mënyrë të tillë që temperatura e gazrave, që rezultojnë nga bashkincinerimi i mbetjeve, të ngrihet, në mënyrë të kontrolluar dhe të njëtrajtshme dhe, madje, edhe në kushtet më të pafavorshme, deri në temperaturën 850°C, për dy sekonda. Në qoftë se bashkincinerohen edhe mbetje të rrezikshme me përmbajtje prej më shumë se 1% substancash organike të halogjenuara, të shprehura si klor, temperatura duhet të ngrihet deri në 1100 °C.

3. Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve duhet të sigurojë që leja e mjedisit për operimin e impianteve të incinerimit dhe bashkincinerimit do të përmbajë kushte që sigurojnë vënien në punë të një sistemi automatik për të parandaluar furnizimin me mbetje:

a) gjatë fazës së fillimit, derisa të arrihet temperatura prej 850°C ose 1100°C, sipas rastit, ose temperatura e specifikuar sipas pikës 4, të këtij kreu;

b) sa herë që nuk ruhet temperatura prej 850°C ose 1100°C, sipas rastit, apo temperatura e specifikuar sipas pikës 4 të këtij kreu;

c) sa herë që matjet e vazhdueshme, që kërkohen nga ky vendim, tregojnë se, për shkak të shqetësimeve apo defekteve të pajisjeve pastruese, ndonjëra nga vlerat kufi të shkarkimit është tejkaluar.

4. Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve, me qëllim që të plotësohen kërkesat e këtij vendimi, mund të autorizojë, sipas rastit, kushte të ndryshme nga ato të parashtruara në pikat 1 dhe 3, të këtij kreu, për sa i përket temperaturës, si dhe ato të specifikuara në lejet përkatëse të mjedisit për disa kategori mbetjesh apo për procese të caktuara termike. Ndryshimi i kushteve operacionale në lejet përkatëse të mjedisit nuk duhet të shkaktojë më shumë mbetje apo mbetje me përmbajtje më të lartë të ndotësve organikë në krahasim me mbetjet e pritshme, në bazë të kushteve të parashikuara në pikën 1, të këtij kreu.

5. Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve, me qëllim që të plotësohen kërkesat e këtij vendimi, mund të autorizojë, sipas rastit, kushte të ndryshme nga ato të parashtruara në pikat 4 dhe 5 të këtij kreu, për sa i përket temperaturës, dhe të specifikuara në lejet përkatëse të mjedisit për disa kategori mbetjesh apo për procese të caktuara termike. Një autorizim i tillë duhet të vendosë si kusht, të paktën, respektimin/përmbushjen e dispozitave për vlerat kufi të shkarkimeve për karbonin organik total dhe oksidin e karbonit (CO), të përcaktuar në aneksin V të këtij vendimi.

6. Në rastin e bashkincinerimit të mbetjeve të veta në vendin e gjenerimit të tyre, në kaldajat ekzistuese të industrisë së letrës dhe brumit të letrës, autorizimi i përcaktuar në pikën 5 të këtij kreu, duhet të vendosë kushtin që të respektohen/përmbushen, të paktën, dispozitat për vlerat kufi të shkarkimeve për karbonin organik total, të përcaktuara në aneksin V të këtij vendimi.

#### VII. KUSHTET OPERATIVE SPECIFIKE QË DUHEN PËRFSHIRË NË LEJEN E MJEDISIT NË LIDHJE ME VLERAT KUFI TË SHKARKIMIT NË AJËR

1. Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve, për operimin e një impianti incinerimi ose bashkincinerimi, duhet të sigurojë që leja e mjedisit në lidhje me vlerat kufi të shkarkimit në ajër do të përmbajë kushte të cilat sigurojnë që:

a) Impiantet e incinerimit të projektohen, pajisen, ndërtohen dhe operohen në mënyrë të tillë që gazrat e shkarkuar të mos tejkalojnë vlerat kufi të shkarkimeve të përcaktuara në aneksin V të këtij vendimi;

b) Impiantet e bashkincinerimit të projektohen, pajisen, ndërtohen dhe operohen në mënyrë të tillë që gazrat e shkarkuar të mos tejkalojnë vlerat kufi të shkarkimeve të përcaktuara në aneksin II të këtij vendimi apo të vendosura në përputhje me to.

c) Nëse në një impiant bashkincinerimi më shumë se 40% e nxehtësisë së çliruar vjen nga mbetjet e rrezikshme, do të zbatohen vlerat kufi të shkarkimit, të përcaktuara në aneksin V të këtij vendimi.

Rezultatet e matjeve të bëra, për të verifikuar respektimin e vlerave kufi të shkarkimit, do të standardizohen sipas kushteve të përcaktuara në krrerët XI dhe XII të këtij vendimi.

2. Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve, në rastin e lejes së mjedisit për bashkincinerimin e mbetjeve bashkiake të përziera të patrajuara, i përcakton vlerat përkatëse kufi në përputhje me aneksin V të këtij vendimi, ndërsa aneksi II i tij nuk zbatohet.

3. Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve, kur është e nevojshme, në lejen përkatëse të mjedisit përcakton vlerat kufi të shkarkimit për hidrokarburet aromatike policiklike ose ndotësit e tjerë.

#### VIII. KUSHTET OPERATIVE SPECIFIKE QË DUHEN PËRFSHIRË NË LEJEN E MJEDISIT NË LIDHJE ME SHKARKIMET E UJËRAVE NGA PASTRIMI I GAZRAVE TË SHKARKUARA

1. Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve duhet të sigurojë që leja e mjedisit për operimin e një impianti incinerimi ose bashkincinerimi, në lidhje me shkarkimet e ujërave nga pastrimi i gazrave të shkarkuara, do të përmbajë kushte të cilat sigurojnë që:



a) Shkarkimet në mjedisin ujqor të ujërave të ndotura, që rezultojnë nga pastrimi i gazrave të shkarkuara, do të kufizohen sa më shumë të jetë e mundur dhe në asnjë rast nuk do të kenë vlera më të larta sesa vlerat kufi të shkarkimeve, të përcaktuara në aneksin IV të këtij vendimi.

b) Ujërat e ndotura, që rezultojnë nga pastrimi i gazrave të shkarkuara, do të shkarkohen në mjedisin ujqor pas trajtimit veçmas të tyre, me kusht që:

i) të përmbushen kërkesat e normave të cilësisë së mjedisit dhe normave të shkarkimeve në mjedis, siç përcaktohen nga ligji "Për mbrojtjen e mjedisit", në formën e vlerave kufi të shkarkimeve;

ii) përqendrimet e masës së substancave ndotëse, të referuara në aneksin IV të këtij vendimi, të mos tejkalojnë vlerat kufi të shkarkimeve, të përcaktuara po aty.

c) Territoret e impianteve të incinerimit dhe bashkincinerimit, përfshirë zonat e magazinimit të mbetjeve, do të projektohen në mënyrë të tillë që të parandalojnë shkarkimet e paautorizuara dhe aksidentale të substancave ndotëse në tokë, ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore, në përputhje me dispozitat e parashtruara në legjislacionin përkatës në fuqi.

ç) Kapaciteti magazinues do të jetë i tillë që do të sigurojë mbajtjen e ujërave të ndotura të shiut, që kanë rrjedhur nga impiantet e incinerimit apo bashkincinerimit, ose të ujërave të ndotura që rezultojnë nga derdhjet apo operacionet e shuarjes së zjarreve.

d) Kapaciteti magazinues do të jetë i tillë që do të sigurojë që këto të mund të testohen dhe trajtohen para shkarkimit të tyre, atje ku është e nevojshme.

dh) Hollimi i ujërave të ndotura, me qëllim përmbushjen e vlerave kufi të shkarkimit, të përcaktuara në aneksin IV të këtij vendimi, ndalohet të kryhet.

2. Vlerat kufi të shkarkimeve për ujërat e ndotura, që rezultojnë nga pastrimi i gazrave të shkarkuara dhe që përmbajnë substancat ndotëse, të referuara në aneksin IV të këtij vendimi, duhet të zbatohen, në pikën e shkarkimit të tyre, nga impianti i incinerimit apo bashkincinerimit.

3. Leja e mjedisit për operimin e impiantit të incinerimit ose bashkincinerimit, në lidhje me shkarkimet e ujërave që rezultojnë nga pastrimi i gazrave të shkarkimit, duhet të përmbajë kushte të cilat sigurojnë që kur këto ujëra të ndotura trajtohen në territorin e impiantit bashkë me ujëra të tjera të ndotura që gjenden aty, operatori duhet të marrë masat e referuara në krerët XI dhe XII të këtij vendimi:

a) për rrymën e ujërave të ndotura nga pastrimi i gazrave të shkarkimit para futjes së tyre në impiantin e përbashkët të trajtimit të ujërave të ndotura.

b) për rrymën/rrymat e tjera të ujërave të ndotura para futjes së saj/ tyre në impiantin e përbashkët të trajtimit të ujërave të ndotura.

c) në pikën e shkarkimit përfundimtar të ujërave të ndotura, pas trajtimit, nga impianti i incinerimit apo bashkincinerimit.

Operatori duhet të bëjë llogaritjet e duhura të bilancit të masës, me qëllim që të përcaktojë nivelet e shkarkimeve që rezultojnë nga pastrimi i gazrave të shkarkuara në mënyrë që të kontrollojë respektimin e vlerave kufi të shkarkimeve, të përcaktuara në aneksin IV të këtij vendimi.

Ndalohet hollimi i ujërave të ndotura, në çdo rrethanë, me qëllim përmbushjen (respektimin) e vlerave kufi të shkarkimit, të përcaktuara në aneksin IV të këtij vendimi.

4. Leja e mjedisit për operimin e impiantit të incinerimit ose bashkincinerimit, në lidhje me shkarkimet e ujërave nga pastrimi i gazrave të shkarkimit, duhet të përmbajë kushte të cilat sigurojnë që:

a) Kur ujërat e ndotura nga pastrimi i gazrave të shkarkimit, që përmbajnë substancat ndotëse të referuara në aneksin IV të këtij vendimi, trajtohen jashtë impiantit të incinerimit apo bashkincinerimit në një impiant trajtimi që përdoret vetëm për trajtime të këtyre llojeve ujërash të ndotura, vlerat kufi të shkarkimeve, të përcaktuara sipas aneksit IV të këtij vendimi, duhet të zbatohen në pikën ku ujërat e ndotura largohen nga impianti i trajtimit.

b) Në qoftë se impianti i trajtimit, që ndodhet jashtë territorit të impiantit të incinerimit, nuk merret vetëm me trajtimin e ujërave të ndotura të incinerimit, operatori duhet të bëjë llogaritjet e duhura të bilancit të masës, siç parashikohet në shkronjat "a", "b" dhe "c", të pikës 3 të këtij kreu, me qëllim që të përcaktojë nivelet e shkarkimeve që rezultojnë nga pastrimi i gazrave të shkarkuara në totalin e ujërave të ndotura përfundimtare, me qëllim që të kontrollojë respektimin e vlerave kufi të shkarkimeve

për rrymën e ujërave të ndotura nga pastrimi i gazrave të shkarkimit, të përcaktuara në aneksin IV, të këtij vendimi.

Ndalohet hollimi i ujërave të ndotura në çfarëdo rrethane, me qëllim përmbushjen (respektimin) e vlerave kufi të shkarkimit, të përcaktuara në aneksin IV të këtij vendimi.

5. Leja e mjedisit për operimin e impiantit të incinerimit ose bashkincinerimit, në lidhje me shkarkimet e ujërave nga pastrimi i gazrave të shkarkuara, duhet:

a) të përcaktojë vlerat kufi të shkarkimit për substancat ndotëse të referuara në aneksin IV, të këtij vendimi, në përputhje me shkronjën “a” të pikës 1 të këtij kreu, dhe me qëllim plotësimin e kërkesave të referuara në shkronjën “b”, nënndarja “i” po të pikës 1;

b) të vendosë parametrat e kontroleve operacionale për ujërat e ndotura, të paktën, për pH-in, temperaturën dhe fluksin.

6. Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve, kur është e nevojshme, cakton në lejen e mjedisit vlerat kufi të shkarkimeve për hidrokarburet aromatike policiklike ose për ndotës të tjerë.

#### IX. KUSHTET OPERATIVE SPECIFIKE, QË DUHEN PËRFSHIRË NË LEJEN E MJEDISIT, NË LIDHJE ME TEPRICAT E MBETJEVE

Leja e mjedisit për operimin e impiantit të incinerimit ose bashkincinerimit, në lidhje me tepricat e mbetjeve që rezultojnë nga operimi i tyre, duhet të përmbajë kushte që sigurojnë që:

a) tepricat e mbetjeve të minimizohen në sasi dhe rrezikshmëri;

b) tepricat e mbetjeve të riciklohen, atje ku është e përshtatshme, drejtpërdrejt në impiant apo jashtë tij, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

c) transportimi dhe depozitimi i menjëhershëm i tepricave të mbetjeve të thata në trajtë pluhuri (p.sh., nga kaldaja dhe nga trajtimi i gazrave të shkarkimit) të kryhen në mënyrë të tillë që të parandalohet përhapja në mjedis duke përdorur kontejnerë të mbyllur ose mjete të tjera të përshtatshme;

ç) Para caktimit të rrugëve që do të ndiqen për asgjësimin apo riciklimin e tepricave të mbetjeve nga impiantet e incinerimit dhe bashkincinerimit, duhet të kryhen testet e duhura për të përcaktuar karakteristikat fizike e kimike dhe potencialin ndotës të tepricave të mbetjeve të ndryshme nga incinerimi. Analizat duhet të bëhen në lidhje me fraksionet e tretshme totale, si edhe me fraksionet e tretshme të metaleve të rënda.

#### X. KUSHTET OPERATIVE SPECIFIKE, QË DUHEN PËRFSHIRË NË LEJEN E MJEDISIT, NË LIDHJE ME KONTROLLIN DHE MONITORIMIN

1. Leja e mjedisit për operimin e impiantit të incinerimit ose bashkincinerimit, në lidhje me kontrollin dhe monitorimin e operimit të tyre, duhet të përmbajë kushte që sigurojnë që:

a) Do të instalohen pajisje matëse dhe do të përdoren teknika për monitorimin e parametrave, kushteve dhe përqendrimeve të masës lidhur me procesin e incinerimit dhe bashkincinerimit;

b) Kalibrimi i pajisjeve automatike të monitorimit, për shkarkimet në ajër dhe ujë, do të kryhet, të paktën çdo tre vjet, me anë të matjeve paralele me metodat e referencës;

c) Matjet periodike të shkarkimeve në ajër dhe ujë do të kryhen në përputhje me pikat 1 dhe 2 të aneksit III të këtij vendimi.

2. Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve duhet të kontrollojë, në mënyrë periodike, dhe të kryejë një testim vjetor mbikëqyrës për të siguruar funksionimin e duhur të instalimit të përshtatshëm, si edhe funksionimin e pajisjeve automatike të monitorimit, për shkarkimet në ajër dhe ujë.

3. Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve do të caktojë vendin e marrjes së mostrave ose pikat e matjes, si pjesë e kushteve të lejes së mjedisit.

#### XI. KUSHTET OPERATIVE SPECIFIKE, QË DUHEN PËRFSHIRË NË LEJEN E MJEDISIT, NË LIDHJE ME MATJET E SHKARKIMEVE NË AJËR

1. Leja e mjedisit për operimin e një impianti incinerimi ose bashkincinerimi duhet të përcaktojë kërkesa për matjet e ndotësve të ajrit dhe të përmbajë kushte të cilat sigurojnë që:

a) Në përputhje me aneksin III të këtij vendimi, në impiantet e incinerimit dhe bashkincinerimit do të kryhen këto matje të ndotësve të ajrit:



i) Matje të vazhdueshme të substancave NOx, me kusht që vlerat kufi të shkarkimeve të jenë caktuar, CO, pluhuri total, TOC, HCl, HF, SO<sub>2</sub> (aneksi III);

ii) Matje të vazhdueshme të parametrave të operacioneve të procesit: temperaturës pranë murit të brendshëm apo në një pikë tjetër përfaqësuese të dhomës së bashkincinerimit, që është autorizuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, përqendrimit të oksigjenit, trysnisë, si dhe temperaturës e përbërjes së avujve të ujit në gazrat e shkarkuara;

iii) Të paktën dy matje në vit për metalet e rënda, dioksinat dhe furanet; sidoqoftë, gjatë 12 muajve të parë të operimit duhet bërë, së paku, një matje çdo tre muaj;

iv) Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve, në qoftë se në lejen e mjedisit përcakton vlerat kufi të shkarkimeve për hidrokarburet aromatike policiklike ose për ndotës të tjerë, përcakton, gjithashtu, edhe periudhat përkatëse të matjeve.

b) Koha e qëndrimit, temperatura minimale dhe përmbajtja e oksigjenit në gazrat e shkarkuara do t'i nënshtrohen verifikimit të duhur, të paktën, një herë kur impianti i incinerimit ose bashkincinerimit të jetë vënë në shërbim dhe në kushtet më të pafavorshme të parashikueshme të operimit.

c) Rezultatet e matjeve të bëra për verifikimin e përmbushjes (respektimit) së vlerave kufi të shkarkimeve do të standardizohen, sipas kushteve të mëposhtme, ndërsa për oksigjenin sipas formulës së referuar në aneksin VI, të këtij vendimi:

i) Temperatura 273K (Kelvin), trysnia 101,3 kPa (kiloPaskal), 11% oksigjen, gaz i thatë, në gazin e shkarkuar të impianteve të bashkincinerimit;

ii) Temperatura 273K, trysnia 101,3 kPa, 3% oksigjen, gaz i thatë, në gazin e shkarkuar nga incinerimi i vajrave të përdorur;

iii) Kur mbetjet incinerohen apo bashkincinerohen në ajër të pasuruar me oksigjen, rezultatet e matjeve mund të standardizohen në bazë të përmbajtjes së oksigjenit të përcaktuar nga Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve, duke pasqyruar rrethanat e veçanta të çdo rasti individual;

iv) Në rastin e bashkincinerimit, rezultatet e matjeve do të standardizohen në bazë të përmbajtjes totale të oksigjenit, siç janë llogaritur në aneksin II, të këtij vendimi.

ç) Kur, si rezultat i trajtimit të gazrave të shkarkimit, shkarkimet e ndotësve nga një impiant incinerimi apo bashkincinerimi të mbetjeve të rrezikshme pakësohen, standardizimi sipas përmbajtjes së oksigjenit, i parashikuar në shkronjën "c", nënndarja "i", të kësaj pike, do të kryhet vetëm në qoftë se përmbajtja e oksigjenit në ndotësin në fjalë, e matur gjatë të njëjtës periudhë, e tejkalon përmbajtjen përkatëse standarde të oksigjenit.

2. Leja e mjedisit për operimin e një impianti incinerimi ose bashkincinerimi mund të përmbajë edhe kushte të tjera, lidhur me teknikat e matjeve, sipas të cilave, për metalet e rënda, dioksinat dhe furanet duhen kryer matje të vazhdueshme të vlerave kufi të shkarkimeve në ajër siç, parashikohet nga legjisllacioni në fuqi, në përputhje me aneksin III, të këtij vendimi.

3. Matja e vazhdueshme e HF mund të mënjanohet nëse përdoren fazat e trajtimit për HCl, të cilat sigurojnë që vlera kufi e shkarkimit për HCl nuk është tejkualuar. Në këtë rast, shkarkimet e HCl duhet t'i nënshtrohen matjeve periodike, të parashikuara në shkronjën "a", nënndarja "iii", të pikës 1 të këtij kreu.

4. Matja e vazhdueshme e përbërjes së avujve të ujit nuk do të kërkohet nëse mostra e gazit të shkarkimit thahet para se të bëhet analiza e shkarkimeve.

5. Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve, në lejen mjedisore të impiantit të incinerimit ose bashkincinerimit, për HCl, HF dhe SO<sub>2</sub>, në vend të matjeve të vazhdueshme mund të autorizojë matjet periodike, të parashikuara në shkronjën "a", nënndarja "iii", të pikës 1 të këtij kreu, në qoftë se operatori mund të vërtetojë që shkarkimet e këtyre ndotësve në asnjë rrethanë nuk janë më të larta se vlerat kufi të shkarkimeve të përcaktuara.

6. Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve mund të autorizojë, në lejen e mjedisit, reduktimin e frekuencës së matjeve periodike për metalet e rënda nga dy herë në vit në një herë në çdo dy vjet dhe për dioksinat e furanet nga dy herë në vit në një herë për çdo vit tek, me kusht që shkarkimet që rezultojnë nga incinerimi ose bashkincinerimi të jenë poshtë nivelit 50% të vlerave kufi të shkarkimeve, të

vendosura respektivisht në përputhje me aneksin II ose aneksin V të këtij vendimi.

7. Kushtet e lejes së mjedisit për operimin e një impianti incinerimi ose bashkincinerimi në lidhje me vlerat kufi të shkarkimit në ajër, konsiderohen si të përmbushura (respektuara) vetëm në qoftë se:

a) asnjëra prej vlerave mesatare ditore nuk i tejkalon vlerat kufi të shkarkimeve, të përcaktuara në aneksin V, shkronja “a” apo në aneksin II të këtij vendimi;

b) 97% e vlerës mesatare ditore gjatë vitit nuk e tejkalon vlerën kufi të shkarkimit, të përcaktuar në aneksin V, shkronja “e”, pika e parë;

c) ose asnjëra prej vlerave mesatare gjysmorëshe nuk i tejkalon vlerat kufi të shkarkimeve, të përcaktuara në aneksin V, shkronja “b”, kolona “A” të këtij vendimi, ose, atje ku ka lidhje, 97% e vlerave mesatare gjysmorëshe gjatë vitit nuk i tejkalojnë vlerat kufi të shkarkimeve, të përcaktuara në aneksin V, shkronja “b”, kolona “B” të këtij vendimi;

ç) asnjëra nga vlerat mesatare, gjatë periudhës së marrjes së mostrës, të përcaktuar për metalet e rënda, dioksinat dhe furanet nuk i tejkalojnë vlerat kufi të shkarkimeve, të përcaktuara në aneksin V të këtij vendimi (c) dhe (d) ose aneksin II;

d) dispozitat e aneksit V, shkronja “e”, kryeradha e dytë, ose të aneksit II të këtij vendimi janë përmbushur.

8. Vlerat mesatare gjysmorëshe dhe mesataret 10-minutëshe përcaktohen brenda kohës efektive të operimit, duke përfshirë periudhat e fillimit dhe mbylljes, nëse nuk po incinerohet asnjë mbetje, nga vlerat e matura pasi është zbritur vlera e intervalit të konfidencës (besimit), e specifikuar në pikën 3, të aneksit III, bashkëlidhur këtij vendimi. Vlerat mesatare përcaktohen në bazë të vlerave mesatare të vlefshme.

9. Vlerat mesatare përgjatë periudhës së marrjes së mostrës, si edhe vlerat mesatare, në rastin e matjeve periodike të HF, HCl dhe SO<sub>2</sub>, përcaktohen në përputhje me kërkesat e kushteve përkatëse të lejes së mjedisit në përputhje me dispozitat e kreut X të këtij vendimi dhe të aneksit III, bashkëlidhur këtij vendimi.

10. Operatori i impiantit të incinerimit ose bashkincinerimit duhet të njoftojë menjëherë Agjencinë e Mjedisit dhe Pyjeve, në qoftë se matjet e kryera tregojnë se vlerat kufi të shkarkimeve në ajër, të parashikuara në këtë vendim, janë tejkaluar.

11. Ministri, me urdhër, miraton formatin e regjistrimit, përpunimit dhe raportimit të rezultateve të matjeve për operimin e impianteve të incinerimit ose bashkincinerimit.

## XII. KUSHTET OPERATIVE SPECIFIKE, QË DUHEN PËRFSHIRË NË LEJEN E MJEDISIT, NË LIDHJE ME MATJET E SHKARKIMEVE NË UJË

1. Leja përkatëse mjedisore për operimin e impianteve të incinerimit ose bashkincinerimit përcakton kërkesat për matjen e ndotësve të ujit dhe përmban kushte të cilat sigurojnë që:

a) Në pikën e shkarkimit të ujërave të ndotura do të kryhen:

i) matjet e vazhdueshme të parametrave të referuar në shkronjën “b” të pikës 5 të kreut VIII të këtij vendimi;

ii) matjet ditore të mostrave për lëndët e ngurta totale pezull të marra në vend. Në vend të tyre, në kushtet e lejes së mjedisit, Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve mund të kërkojë edhe matje të një mostre përfaqësuese në proporcion me fluksin e një periudhe prej 24 orësh;

iii) të paktën matjet mujore të një mostre përfaqësuese të substancave ndotëse të referuara në shkronjën “b” të pikës 1 të kreut VIII, të këtij vendimi, dhe në pikat 2 deri në 10 të aneksit IV, në proporcion me fluksin e një periudhe prej 24 orësh;

iv) të paktën çdo gjashtë muaj, matjet e dioksinave dhe furaneve; sidoqoftë për 12 muajt e parë të operimit duhet të kryhet një matje çdo tre muaj;

Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve kur përcakton, në lejet e mjedisit, vlerat kufi të shkarkimeve për hidrokarburet policiklike aromatike ose për ndotës të tjerë, përcakton, gjithashtu, edhe periudhat përkatëse të matjeve.

b) Monitorimi i masës së ndotësve në ujërat e ndotura të trajtuara duhet të bëhet sipas legjislacionit përkatës në fuqi dhe të përcaktohet në lejen e mjedisit së bashku me frekuencën e matjeve.





2. Kushtet e lejes së mjedisit për operimin e një impianti incinerimi ose bashkincinerimi, që lidhen me vlerat kufi të shkarkimeve për ujin, duhet të konsiderohen si të përmbushura nëse:

a) për lëndët e ngurta totale pezull (substancat ndotëse numër 1) 95% dhe 100% e vlerave të matura nuk i tejkalojnë vlerat respektive kufi të shkarkimeve, të përcaktuara në aneksin IV të këtij vendimi;

b) për metalet e rënda (substancat ndotëse numër 2 deri në 10) jo më shumë se një matje në vit i tejkalon vlerat kufi të shkarkimeve, të përcaktuara në aneksin IV; ose, nëse leja e mjedisit parashikon më shumë se 20 mostra në vit, jo më shumë se 5% e këtyre mostrave i tejkalon vlerat kufi të shkarkimeve, të përcaktuara në aneksin IV;

c) për dioksinat dhe furanet (substancat ndotëse numër 11) matjet e bëra dy herë në vit nuk e tejkalojnë vlerën kufi të shkarkimit, të përcaktuar në aneksin IV të këtij vendimi.

3. Operatori i impiantit të incinerimit ose bashkincinerimit duhet të lajmërojë menjëherë Agjencinë e Mjedisit dhe Pyjeve, në qoftë se matjet e kryera tregojnë që vlerat kufi të shkarkimeve për ujin, të përcaktuara në këtë vendim, janë tejkaluar.

### XIII. KUSHTET OPERATIVE SPECIFIKE, QË DUHEN PËRFSHIRË NË LEJEN E MJEDISIT, NË LIDHJE ME KUSHTET OPERATIVE JONORMALE

Leja e mjedisit për operimin e një impianti incinerimi ose bashkincinerimi duhet të përmbajë kushte të cilat sigurojnë që:

a) është caktuar periudha maksimale e lejueshme për ndalimet, shqetësimet ose defektet teknike të pashmangshme të pajisjeve të pastrimit apo atyre të matjes, gjatë të cilave përqendrimet e shkarkimeve të substancave të rregulluara në ajër dhe ujërat e ndotura të pastruara mund të tejkalojnë vlerat kufi të caktuara;

b) operatori duhet të reduktojë ose të ndalojë operacionet sa më shpejt të jetë e mundur, derisa të mund të rifillojnë operacionet normale;

c) pavarësisht nga parashtrimi i shkronjës “c” të pikës 3 të kreut VI të këtij vendimi, impianti i incinerimit apo i bashkincinerimit, ose linja e incinerimit në asnjë rrethanë nuk duhet të vazhdojë të incinerojë mbetje për më shumë se katër orë rresht, pa ndërprerje, në rast se janë tejkaluar vlerat kufi të shkarkimeve; për më tepër, kohëzgjatja e akumuluar e operacioneve në këto kushte, gjatë një viti, duhet të jetë më e vogël se 60 orë. Kohëzgjatja prej 60 orësh zbatohet për ato linja të të gjithë impiantit që janë të lidhura me një pajisje pastruese të vetme të gazeve të oxhakat.

ç) Përmbajtja totale e pluhurit të shkarkimeve në ajër e një impianti incinerimi në asnjë rrethanë nuk duhet të tejkalojë 150 mg/m<sup>3</sup> e shprehur si mesatare gjysmorëshe; për më tepër, vlerat kufi të shkarkimeve në ajër të CO dhe TOC nuk duhet të tejkalohen.

### XIV. KËRKESA TË PËRGGJITHSHME PËR DËRGIMIN DHE MARRJEN NË DORËZIM TË MBETJEVE

1. Operatori i impiantit të incinerimit apo bashkincinerimit duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme paraprake në lidhje me dërgimin dhe marrjen në dorëzim të mbetjeve, me qëllim parandalimin apo kufizimin sa më shumë të jetë e mundur të efekteve negative mbi mjedisin, në veçanti ndotjen e ajrit, tokës, ujërave sipërfaqësore e atyre nëntokësore, si edhe aromat, zhurmën dhe rreziqet e drejtpërdrejta ndaj shëndetit të njeriut. Këto masa duhet që, të paktën, të plotësojnë kërkesat e parashikuara në pikat 2 e 3, të këtij kreu.

2. Operatori, nëse është e mundur, para pranimit të mbetjeve në impiantin e incinerimit apo të bashkincinerimit duhet të përcaktojë masën e çdo kategorie të mbetjeve, sipas vendimit nr. 99, datë 18.2.2005 të Këshillit të Ministrave “Mbi miratimin e Katalogut Shqiptar për Klasifikimin e Mbetjeve”.

3. Para pranimit të mbetjeve të rrezikshme në impiantin e incinerimit apo të bashkincinerimit, operatori duhet të ketë informacionin e disponueshëm me qëllim verifikimin, ndër të tjera, edhe të përmbushjes së kërkesave të lejes, të specifikuar në pikën 2, të kreut V të këtij vendimi. Ky informacion duhet të përfshijë:

a) të gjithë informacionin administrativ për procesin e gjenerimit të mbetjeve, nga dokumentet e përmendura në shkronjën “a” të pikës 1 të kreut V të këtij vendimi;

b) përbërjen fizike e, sa më shumë të jetë e mundur, atë kimike të mbetjeve, si dhe të gjitha informacionet e tjera të nevojshme për vlerësimin e përshtatshmërisë së tyre për procesin e synuar të bashkincinerimit;

c) karakteristikat e rrezikshme të mbetjeve, substancat me të cilat ato nuk mund të përzihen, si edhe masat paraprake që duhen marrë gjatë trajtimit të mbetjeve.

4. Para pranimit të mbetjeve në impiantin e incinerimit apo bashkincinerimit, operatori paraprakisht duhet që:

a) Të kryejë kontrollin e dokumenteve që kërkohen nga ligji “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”;

b) Të marrë mostrat përfaqësuese, sa më parë të jetë e mundur, përpara shkarkimit të tyre, p.sh., për mbetjet spitalore infektive, duke ushtruar kontrole për të verifikuar përputhshmërinë me informacionin e parashikuar në pikën 3 të këtij kreu, dhe për të bërë të mundur që Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve të identifikojë natyrën e mbetjeve që do të trajtohen. Këto mostra duhet të ruhen për, të paktën, një muaj pas incinerimit.

5. Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve mund të lejojnë përjashtime nga sa është parashikuar në pikat 2, 3 dhe 4 të këtij kreu, për impiantet industriale dhe ndërmarrjet që incinerojnë apo bashkincinerojnë mbetjet e veta në vendin e gjenerimit të mbetjeve, me kusht që të përmbushen kërkesat e këtij vendimi.

#### XV. DISPOZITA TRANSITORE

1. Pavarësisht nga dispozitat transitorë specifike, të përcaktuara në anekset e këtij vendimi, dispozitat e tij zbatohen për impiantet ekzistuese që nga data 1 janar 2016.

2. Për impiantet e reja, siç janë impiantet që nuk kategorizohen nën përkufizimin “impianti ekzistues i incinerimit ose bashkincinerimit”, dispozitat e këtij vendimi zbatohen nga data e hyrjes së tij në fuqi.

3. Impiantet e palëvizshme/fikse ose të lëvizshme, qëllimi i të cilave është gjenerimi i energjisë ose prodhimi i produkteve materiale dhe që janë në funksionim e kanë një leje mjedisi në përputhje me legjisllacionin në fuqi, dhe që fillojnë bashkincinerimin e mbetjeve jo më vonë se data 1 janar 2015, duhet të konsiderohen si impiante ekzistuese me bashkincinerim.

4. Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve, në lejen përkatëse të mjedisit, mund të autorizojë reduktimin e frekuencës së matjeve periodike, të parashikuar në pikën 1 të kreut XI të këtij vendimi, për metalet e rënda, dioksinat dhe furanet deri më 1 janar të vitit 2016, edhe në qoftë se kriteret e përcaktuara në pikën 1, të kreut XI, të këtij vendimi, nuk plotësohen, me kusht që:

a) mbetjet që duhen bashkincineruar ose incineruar të përbëhen vetëm nga fraksione të caktuara të përzgjedhura të mbetjeve jo të rrezikshme të djegshme, që nuk janë të përshtatshme për riciklim e që paraqesin karakteristika të caktuara, dhe të cilat më tej do të specifikohen në bazë të vlerësimit të referuar në shkronjën “ç” të kësaj pike;

b) bashkincinerimi dhe incinerimi i këtyre mbetjeve të jetë në përputhje me planet përkatëse të menaxhimit të mbetjeve, të referuara në ligjin “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”;

c) operatori të mund t’i provojë Agjencisë së Mjedisit dhe Pyjeve që shkarkimet janë në të gjitha rrethanat të konsiderueshme nën vlerat limit të shkarkimeve, të përcaktuara në aneksin II ose aneksin V bashkëlidhur këtij vendimi, për metalet e rënda, dioksinat dhe furanet; ky vlerësim duhet të bazohet në informacionin mbi cilësinë e mbetjeve që lidhen me të dhe matjet e shkarkimeve të këtyre ndotësve;

ç) kriteret e cilësisë dhe periudha e re për matjet periodike të jenë specifikuar në lejet përkatëse të mjedisit.

#### XVI. MONITORIMI DHE RAPORTIMI

1. Inspektorati Kombëtar i Mjedisit duhet të kryejë, të paktën, dy herë në vit inspektime të impianteve të incinerimit dhe bashkincinerimit, në përputhje me ligjet “Për lejet e mjedisit” dhe “Për mbrojtjen e mjedisit”.

2. Operatori i impianteve të incinerimit ose bashkincinerimit duhet të sigurojë që rezultatet e të gjitha matjeve që kërkohen të bëhen sipas këtij vendimi dhe në përputhje me lejen e mjedisit, janë regjistruar, përpunuar dhe paraqitur në mënyrën e duhur, me qëllim që Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve



dhe Inspektorati Kombëtar i Mjedisit të mund të verifikojnë përmbushjen e kushteve të përcaktuara në lejen e mjedisit dhe të vlerave limit të shkarkimeve, të përcaktuara në këtë vendim.

3. Operatori i impianteve të incinerimit ose bashkincinerimit, të cilat kanë një kapacitet nominal prej dy ose më shumë tonë për orë, duhet të përgatisë një raport vjetor për funksionimin dhe monitorimin e impiantit. Raporti duhet, minimalisht, të japë llogari për mbarëvajtjen e procesit e të shkarkimeve në ajër dhe në ujë, duke e krahasuar me normat e shkarkimeve të përcaktuara në këtë vendim.

4. Operatori duhet ta dorëzojë raportin, e përmendur në pikën 3 të këtij kreu, në Agjencinë e Mjedisit dhe Pyjeve dhe Inspektoratin Kombëtar të Mjedisit brenda datës 30 nëntor të çdo viti kalendarik. Raporti duhet të jetë i disponueshëm për publikun, në përputhje me kërkesat e ligjit “Për mbrojtjen e mjedisit”. Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve raporton periodikisht në Ministri dhe në Komitetin Ndërmnistror për Mbetjet rezultatet e monitorimit në impiantet e incinerimit apo bashkincinerimit nga Inspektorati Kombëtar i Mjedisit, për plotësimin e kriteve të përcaktuara në këtë vendim.

5. Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve duhet të mbajë një listë të përditësuar të impianteve të incinerimit ose bashkincinerimit me një kapacitet nominal më pak se dy tonë për orë. Kjo listë duhet të jetë e disponueshme për publikun, në përputhje me kërkesat e ligjit “Për mbrojtjen e mjedisit”.

#### XVII. PROCEDURAT E MBYLLJES DHE TË KUJDESIT TË MËTEJSHËM

1. Operatori fillon procedurat e mbylljes dhe të kujdesit të mëtejshëm të incineratorit kur:

- a) janë përmbushur kushtet përkatëse, të përcaktuara në lejen e mjedisit; ose
- b) kur kërkesa e tij për mbyllje është miratuar nga Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve; ose
- c) kur kërkohet, me një vendim të argumentuar, nga Agjencia e Mjedisit dhe e Pyjeve.

2. Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve, përpara se të vendosë të miratojë ose jo mbylljen e incineratorit, kryen së bashku me Inspektoratin Kombëtar të Mjedisit një inspektim përfundimtar në vend dhe vlerëson të gjitha raportet e dorëzuara nga operatori.

3. Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve, kur vlerëson se janë përmbushur të gjitha kërkesat e vendosura në lejen e mjedisit dhe që vendi i incineratorit nuk paraqet ndonjë rrezik për shëndetin e njeriut ose mjedisin ku ai funksionon, i komunikon, me shkrim, operatorit vendimin për miratimin e mbylljes së incineratorit.

#### XVIII. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Ministri është përgjegjës për nxjerrjen e akteve normative për zbatimin e pikës 11, të kreut XI, të këtij vendimi.

2. Emërtimi “Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve” do të zëvendësohet me “Agjencia Kombëtare e Mjedisit”, pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”.

3. Ngarkohet Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

## ANEKSI I

### FAKTORËT E EKVIVALENCËS PËR DIBENZO-P-DIOKSINAT DHE DIBENZOFURANET

Për përcaktimin e përqendrimit total (TE) të dioksinave dhe furaneve, përqendrimet e masës së dibenzo-p-dioksinave dhe dibenzofuraneve të mëposhtme para mbledhjes së tyre duhet të shumëzohen me faktorët e mëposhtëm të ekuivalencës:

Faktori i ekuivalencës toksike

2,3,7,8	— Tetraklorurdibenzodioksinë (TCDD)	1
1,2,3,7,8	— Pentaklorurdibenzodioksinë (PeCDD)	0,5
1,2,3,4,7,8	— Hekzaklorurdibenzodioksinë (HxCDD)	0,1
1,2,3,6,7,8	— Hekzaklorurdibenzodioksinë (HxCDD)	0,1
1,2,3,7,8,9	— Hekzaklorurdibenzodioksinë (HxCDD)	0,1
1,2,3,4,6,7,8	— Heptaklorurdibenzodioksinë (HpCDD)	0,01
	— Oktaklorurdibenzodioksinë (OCDD)	0,001
2,3,7,8	— Tetraklorurdibenzofuran (TCDF)	0,1
2,3,4,7,8	— Pentaklorurdibenzofuran (PeCDF)	0,5
1,2,3,7,8	— Pentaklorurdibenzofuran (PeCDF)	0,05
1,2,3,4,7,8	— Hekzaklorurdibenzofuran (HxCDF)	0,1
1,2,3,6,7,8	— Hekzaklorurdibenzofuran (HxCDF)	0,1
1,2,3,7,8,9	— Hekzaklorurdibenzofuran (HxCDF)	0,1
2,3,4,6,7,8	— Hekzaklorurdibenzofuran (HxCDF)	0,1
1,2,3,4,6,7,8	— Heptaklorurdibenzofuran (HpCDF)	0,01
1,2,3,4,7,8,9	— Heptaklorurdibenzofuran (HpCDF)	0,01
	— Oktaklorurdibenzofuran (OCDF)	0,001

## ANEKSI II

### PËRCAKTIMI I VLERAVE KUFË TË SHKARKIMEVE NË AJËR PËR BASHKINCINERIMIN E MBETJEVE

Formula e mëposhtme (rregulli i përzierjes) duhet të zbatohet sa herë që një vlerë kufi e shkarkimit specifik total "C" nuk është përcaktuar në ndonjë nga tabelat e këtij aneksi.

Vlera kufi për ndotësin përkatës dhe monoksidin e karbonit në gazet e shkarkuara që rezultojnë nga bashkëincinerimi i mbetjeve do të llogaritet si më poshtë vijon:

$$V_{\text{mbetjeve}} \times C_{\text{mbetjeve}} + V_{\text{proc}} \times C_{\text{proc}} = C$$

$$V_{\text{mbetjeve}} + V_{\text{proc}} = 1$$

$$\frac{V_{\text{waste}} \times C_{\text{waste}} + V_{\text{proc}} \times C_{\text{proc}}}{V_{\text{waste}} + V_{\text{proc}}} = C$$

Vmbetjeve: Vëllimi i gazeve të shkarkuara që rezultojnë nga incinerimi i mbetjeve, i përcaktuar vetëm nga mbetjet e specifikuar në lejen përkatëse të mjedisit që kanë vlerën më të ulët kalorifike dhe që janë standardizuar sipas kushteve të dhëna nga ky vendim.

Nëse çlirimi i nxehtësisë që rezultojnë nga incinerimi i mbetjeve të rrezikshme përbën më pak se 10% të sasisë totale të nxehtësisë së çliruar në impiant, Vmbetjeve duhet të llogaritet nga sasia (nominale) e mbetjeve që, kur incinerohen, përbëjnë 10% të nxehtësisë së çliruar të një çlirimi total të nxehtësisë së dhënë.



Cmbetjeve: Vlerat kufi të shkarkimeve të përcaktuara për impiantet e incinerimit në Aneksin V për ndotësit përkatës dhe monoksidin e karbonit.

Vproc: Vëllimi i gazeve të shkarkuara që rezultojnë nga procesi i impiantit duke përfshirë edhe djegien e lëndëve djegëse të autorizuara që përdoren normalisht nëpër impiante (duke përjashtuar mbetjet) të përcaktuara në bazë të përmbajtjes së oksigjenit në të cilën duhet të standardizohen shkarkimet siç përcaktohet në legjislacionin përkatës në fuqi. Në mungesë të këtij legjislacioni për këto lloj impiantesh, duhet të përdoret përmbajtja e vërtetë e oksigjenit në gazet e oxhakut pa u holluar nga shtimi i ajrit që është i panevojshëm për këtë proces. Ky vendim jep standardizimin në kushte të tjera.

Cproc: Vlerat kufi të shkarkimeve për disa sektorë industrialë që përcaktohen në tabelat e këtij aneksi ose, në rastin e mungesës së një table apo të vlerave të tilla, vlerat kufi të shkarkimeve të ndotësve përkatës dhe të monoksidit të karbonit në gazet e oxhakut të impianteve që, kur djegin lëndët djegëse të autorizuara normalisht (duke përjashtuar mbetjet) janë në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi për impiante të tilla. Në mungesë të këtyre masave, përdoren vlerat kufi të shkarkimeve të përcaktuara në lejet përkatëse të mjedisit. Në mungesë të këtyre vlerave në lejen e mjedisit do të përdoren përqendrimet e vërteta të masës.

C: Vlerat kufi të shkarkimeve totale dhe përmbajtja e oksigjenit për disa sektorë industrialë dhe ndotës të caktuar që përcaktohen në tabelat e këtij aneksi, apo, kur kjo tabelë apo vlera të tilla mungojnë, vlerat kufi të shkarkimeve totale për CO dhe ndotës të tjerë që zëvendësojnë vlerat kufi të shkarkimeve të përcaktuara në anekset specifike të këtij vendimi. Përmbajtja totale e oksigjenit që do të zëvendësojë përmbajtjen e oksigjenit për standardizimin llogaritet në bazë të përmbajtjes së mësipërme duke respektuar vëllimet e pjeshme.

#### II.1. Dispozita të veçanta për furrat e çimentos që bashkincinerojnë mbetje

Vlerat mesatare ditore (për matjet e vazhdueshme). Periudhat e marrjes së mostrave dhe kërkesa të tjera për matjet që jepen në seksionin 7 të këtij vendimi. Të gjitha vlerat janë në  $\text{mg}/\text{m}^3$  (përveç dioksinave dhe furaneve që janë në  $\text{ng}/\text{m}^3$ ). Vlerat mesatare gjysmorëshe do të nevojiten vetëm për qëllimin e përlllogaritjes së vlerave ditore mesatare.

Rezultatet e matjeve të bëra për të verifikuar përmbushjen e vlerave kufi të shkarkimeve duhet të standardizohen sipas kushteve të mëposhtme: Temperatura 273 K, trysnia 101,3 kPa, 10% oksigjen, gaz i thatë.

#### II.1.1. C — Vlerat kufi të shkarkimeve totale

Ndotësi	C
Pluhuri total	30
HCl	10
HF	1
NOx për impiantet ekzistuese	800
NOx për impiantet e reja	500 (1)
Cd + Tl	0,05
Hg	0,05
Sb + As + Pb + Cr + Co + Cu + Mn + Ni + V	0,5
Dioksinat dhe furanet	0,1

(1) Për zbatimin e vlerave kufi të shkarkimeve të NOx, furrat e çimentos që janë në punë dhe kanë një leje mjedisi në përputhje me ligjin “Për lejet e mjedisit” dhe që fillojnë të bashkincinerojnë mbetje pas datës së përmendur në paragrafin 50 të këtij vendimi, nuk konsiderohen si impiante të reja.

Agjencia Kombëtare e Mjedisit mund të autorizojë deri më 1 janar 2017 përjashtimet për NOx për furrat ekzistuese të çimentos me proces të lagët apo furrat e çimentos që djegin më pak se tre tonë mbetje në orë me kusht që leja të parashikojë një vlerë kufi shkarkimi total për NOx prej jo më shumë se  $1200 \text{ mg}/\text{m}^3$ .

Agjencia Kombëtare e Mjedisit mund të autorizojë deri më 1 janar 2017 përjashtimet për furrat e çimentos që djegin më pak se tre tonë mbetje në orë, me kusht që leja të parashikojë një vlerë kufi shkarkimi total prej jo më shumë se 50 mg/m<sup>3</sup>.

II.1.2. C - vlerat kufi të shkarkimeve totale për SO<sub>2</sub>, dhe TOC

Ndotësi	C
SO <sub>2</sub>	50
TOC	10

Agjencia Kombëtare e Mjedisit mund të autorizojë përjashtime në rastet kur nga djegia e mbetjeve nuk rezultojnë TOC dhe SO<sub>2</sub>.

II.1.3. Vlera kufi e shkarkimit për CO

Në përcaktimin e kushteve operative që duhet të përfshihen në lejen e mjedisit zbatohen vlerat kufi të shkarkimeve për CO siç përcaktohen nga ligji “Për mbrojtjen e mjedisit” dhe nga ligji “Për lejet e mjedisit”.

II.2. Dispozita të veçanta për impiantet me djegie që bashkincinerojnë mbetje

II.2.1. Vlerat mesatare ditore

Kur, për impiantet e mëdha me djegie, vlerat kufi të shkarkimit në ligjin “Për mbrojtjen e mjedisit” dhe ligjin “Për lejet e mjedisit” janë përcaktuar shumë strikte ato vlera do të zëvendësojnë vlerat kufi të shkarkimit për impiantet dhe për ndotësit që përcaktohen në tabelat që vijojnë (Cproc).

Vlerat mesatare gjysmorëshe nevojiten vetëm për qëllimin e përlllogaritjes së vlerave mesatare ditore.

Cproc:

Cproc për lëndët djegëse të ngurta e shprehur në mg/Nm<sup>3</sup> (përmbajtja e O<sub>2</sub> 6%):

Ndotësit	< 50 MWth	50-100 MWth	100 to 300 MWth	> 300 MWth
SO <sub>2</sub> rast i përgjithshëm		850	850 to 200 (zvogëlim linear nga100 deri 300 MËth)	200
lëndët djegëse të vendit		ose norma e de- sulfurizimit ≥90%	ose norma e de- sulfurizimit ≥92%	ose norma e desulfurizimit ≥95%
NO <sub>x</sub>		400	300	200
Pluhuri	50	50	30	30

Vlerat kufi të shkarkimeve për NO<sub>x</sub> nga impiantet që bashkincinerojnë vetëm mbetje të rrezikshme, pavarësisht nga legjislacioni përkatës në fuqi, nuk do të zbatohen deri më 1 janar 2016.

Agjencia Kombëtare e Mjedisit, deri më 1 janar 2017, mund të autorizojë përjashtime për NO<sub>x</sub> dhe SO<sub>2</sub> për impiantet ekzistuese të bashkincinerimit ndërmjet 100 dhe 300 MWth që përdorin teknologjinë me shtrat të lëngëzuar (fluidised bed) dhe djegin lëndë djegëse të ngurta me kusht që leja e mjedisit të parashikojë një vlerë kufi shkarkimi total (Cproc) prej jo më shumë se 350 mg/Nm<sup>3</sup> për NO<sub>x</sub> dhe jo më shumë se 850-400 mg/Nm<sup>3</sup> (zvogëlimi linear nga 100-300 MWth) për SO<sub>2</sub>.

Cproc për biomasën e shprehur në mg/Nm<sup>3</sup> (përmbajtja e O<sub>2</sub> 6%):

“Biomasë” nënkupton produktet që përmbajnë, tërësisht apo pjesërisht, masë të gjelbër nga bujqësia ose pyjet, që mund të përdoret për rikuperim energjie si edhe mbetjet e renditura në paragrafët (4)(a)(i) deri në (v) të këtij vendimi.



Ndotësit	< 50 MWth	50 to 100 MWth	100 to 300 MWth	> 300 MWth
SO <sub>2</sub>		200	200	200
NO <sub>x</sub>		350	300	300
Pluhuri	50	50	30	30

Agjencia Kombëtare e Mjedisit mund të autorizojë deri më 1 janar 2017 përjashtimet për NO<sub>x</sub> nga impiantet ekzistuese të bashkincinerimit ndërmjet 100 dhe 300 MWth që përdorin teknologjinë me shtrat të lëngëzuar dhe djegien e biomasës me kusht që leja përkatëse e mjedisit të parashikojë një vlerë kufi shkarkimi total (Cproc) prej jo më shumë se 350 mg/Nm<sup>3</sup>.

Cproc për lëndët djegëse të lëngshme e shprehur në mg/Nm<sup>3</sup> (përmbajtja e O<sub>2</sub> 3%):

Ndotësit	< 50 MWth	50 deri 100 MWth	100 deri 300 MWth	> 300 MWth
SO <sub>2</sub>		850	850 to 200 (zvogëlim linear nga 100 në 300 MWth)	200
NO <sub>x</sub>		400	300	200
Pluhuri	50	50	30	30

II.2.2. C —vlerat kufi të shkarkimeve totale

C e shprehur në mg/Nm<sup>3</sup> (përmbajtja e O<sub>2</sub> 6%). Të gjitha vlerat mesatare të matura gjatë një periudhe të marrjes së mostrës nga 30 minuta (minimumi) dhe 8 orë (maksimumi):

Ndotësi	C
Cd + Tl	0,05
Hg	0,05
Sb + As + Pb + Cr + Co + Cu + Mn + Ni + V	0,5

C e shprehur në mg/Nm<sup>3</sup> (përmbajtja e O<sub>2</sub> 6%). Të gjitha vlerat mesatare të matura gjatë periudhës së mostrave nga 6 orë (minimumi) dhe 8 orë (maksimumi):

Ndotësi	C
Dioksinat dhe furanet	0,1

II.3. Dispozitat e veçanta për sektorët e industrisë që bashkincinerojnë mbetje që nuk mbulohen nga II.1. apo II.2.

II.3.1. C -vlerat kufi të shkarkimeve totale:

C e shprehur në mg/Nm<sup>3</sup> (përmbajtja e O<sub>2</sub> 6%). Të gjitha vlerat mesatare të matura gjatë periudhës së marrjes së mostrave nga 6 orë (minimumi) dhe 8 orë (maksimumi):

Ndotësi	C
Dioksinat dhe furanet	0,1

C e shprehur në mg/Nm<sup>3</sup> (përmbajtja e O<sub>2</sub> 6%). Të gjitha vlerat mesatare të matura gjatë periudhës së marrjes së mostrave nga 30 minuta dhe (minimumi) dhe 8 orë (maksimumi):

Ndotësi	C
Cd + Tl	0,05
Hg	0,05

### ANEKSI III TEKNIKAT E MATJES

1. Matjet për përcaktimin e përqendrimeve të substancave ndotëse në ajër dhe ujë duhen të kryhen në mënyrë përfaqësuese.

2. Marrja e mostrave dhe analizimi i të gjithë ndotësve që përfshijnë dioksinat dhe furanet, si dhe metodat e matjeve të referencës për kalibrimin e sistemeve të automatizuara të matjes do të kryhen sipas standardeve shqiptare ose standardeve shqiptare të harmonizuara të përcaktuara nga ligji “Mbi standardizimet”. Në qoftë se standarde të tilla nuk janë të disponueshme, do të zbatohen standarde ISO ose standarde ndërkombëtare që sigurojnë marrjen e të dhënave të një cilësie shkencore të barasvlershme.

3. Në nivelin e vlerës kufi të shkarkimeve ditore, vlerat prej 95% të intervaleve të besueshme të një rezultati të vetëm të matur nuk duhet të tejkalojnë përqindjet e mëposhtme të vlerave kufi të shkarkimeve:

Monoksidi i karbonit:	10 %
Dioksidi i squfurit:	20 %
Dioksidi i azotit:	20 %
Pluhuri total:	30 %
Karboni organik total:	30 %
Kloruri i hidrogjenit:	40 %
Fluoruri i hidrogjenit:	40 %

### ANEKSI IV VLERAT KUFI TË SHKARKIMEVE PËR UJËRAT E NDOTURA NGA PASTRIMI I GAZEVE TË SHKARKUARA

Substancat ndotëse	Vlerat kufi të shkarkimeve të shprehura në përqendrime të masës për mostrat e pa-filtruara	
1. Lëndët e ngurta totale pezull	95 % 30mg=l	100 % 45mg=l
2. Mërkuri dhe përbërjet e tij, të shprehura si mërkur (Hg)	0,03 mg/l	
3. Kadmiumi dhe përbërjet e tij, të shprehura si kadmium(Cd)	0,05 mg/l	
4. Taliumi dhe përbërjet e tij, të shprehura si talium (Tl)	0,05 mg/l	
5. Arseniku dhe përbërjet e tij, të shprehura si arsenik (As)	0,15 mg/l	
6. Plumbi dhe përbërjet e tij, të shprehura si plumb (Pb)	0,2 mg/l	
7. Kromi dhe përbërjet e tij, të shprehura si krom (Cr)	0,5 mg/l	
8. Bakri dhe përbërjet e tij, të shprehura si bakër (Cu)	0,5 mg/l	
9. Nikeli dhe përbërjet e tij, të shprehura si nikel (Ni)	0,5 mg/l	
10. Zinku dhe përbërjet e tij, të shprehura si zink (Zn)	1,5 mg/l	
11. Dioksinat dhe furanet, të përkufizuara si shuma e dioksinave dhe furaneve individuale të vlerësuara në përputhje me aneksin I	0,3 ng/l (nanogram/litër)	

Agjencia Kombëtare e Mjedisit mund të autorizojë përjashtimet për lëndët e ngurta totale pezull nga për impiantet ekzistuese të bashkincinerimit deri më 1 janar 2017 me kusht që leja të parashikojë që 80% e vlerave të matura të mos e tejkalojë 30mg/l dhe asnjë prej tyre të mos e tejkalojë vlerën prej 45mg/l.





ANEKSI V  
VLERAT KUFI TË SHKARKIMEVE NË AJËR

(a) Vlerat mesatare ditore

Pluhuri total	10 mg/m <sup>3</sup>
Substancat e gazta dhe të avullta, të shprehura si karbon organik total	10 mg/m <sup>3</sup>
Kloruri i hidrogjenit (HCl)	10 mg/m <sup>3</sup>
Fluoruri i hidrogjenit (HF)	1 mg/m <sup>3</sup>
Dioksidi i squfurit (SO <sub>2</sub> )	50 mg/m <sup>3</sup>
Monoksidi i azotit (NO) dhe dioksidi i azotit (NO <sub>2</sub> ) të shprehur si dioksid azoti për impiantet ekzistuese të incinerimit me një kapacitet nominal që i tejkalon 6 tonë në orë ose për impiante të reja të incinerimit	200 mg/m <sup>3</sup> (*)
Monoksidi i azotit (NO) dhe dioksidi i azotit (NO <sub>2</sub> ) të shprehur si dioksid azoti për impiantet ekzistuese të incinerimit me një kapacitet nominal që i tejkalon 6 tonë në orë ose më pak	400 mg/m <sup>3</sup> (*)

(\*)Deri më 1 janar 2016 dhe pavarësisht nga ligji “Për mbrojtjen e mjedisit” dhe ligji “Për lejet e mjedisit”, vlera kufi e shkarkimit për NO<sub>x</sub> nuk do të zbatohet për impiantet që incinerojnë vetëm mbetje të rrezikshme.

Agjencia Kombëtare e Mjedisit mund të autorizojë përjashtimet për NO<sub>x</sub> për impiantet ekzistuese të incinerimit:

- me një kapacitet nominal prej 6 tonë në orë, me kusht që leja e mjedisit të parashikojë vlerat mesatare ditore që nuk i tejkalojnë 500mg/m<sup>3</sup> dhe kjo deri më 1 janar 2017

- me një kapacitet nominal prej >6 tonë në orë, por të barabartë apo më të vogël se 16 tonë në orë, me kusht që leja e mjedisit të parashikojë vlerat mesatare ditore që nuk i tejkalojnë 400mg/m<sup>3</sup> dhe kjo deri më 1 janar 2019

- me një kapacitet nominal prej >16 tonë në orë, por <25 tonë në orë dhe që nuk gjenerojnë shkarkime uji, me kusht që leja e mjedisit të parashikojë vlerat mesatare ditore që nuk i tejkalojnë 400mg/m<sup>3</sup> dhe kjo deri më 1 janar 2017

Agjencia Kombëtare e Mjedisit mund të autorizojë përjashtime për pluhurin nga impiantet ekzistuese të incinerimit deri më 1 janar 2017 me kusht që leja e mjedisit të parashikojë që vlerat mesatare ditore të mos i tejkalojnë 20mg/m<sup>3</sup>.

b) Vlerat mesatare gjysmëorëshe

	(100 %) A	(97 %) B
Pluhuri total	30 mg/m <sup>3</sup>	10 mg/m <sup>3</sup>
Substancat e gazta dhe të avullta, të shprehura si karbon organik total	20 mg/m <sup>3</sup>	10 mg/m <sup>3</sup>
Kloruri i hidrogjenit (HCl)	60 mg/m <sup>3</sup>	10 mg/m <sup>3</sup>
Fluoruri i hidrogjenit (HF)	4 mg/m <sup>3</sup>	2 mg/m <sup>3</sup>
Dioksidi i squfurit (SO <sub>2</sub> )	200 mg/m <sup>3</sup>	50 mg/m <sup>3</sup>
Monoksidi i azotit (NO) dhe dioksidi i azotit (NO <sub>2</sub> ) të shprehur si dioksid azoti për impiantet ekzistuese të incinerimit me një kapacitet nominal që i tejkalon 6 tonë në orë ose impiante të reja incinerimi	400 mg/m <sup>3</sup> (*)	200 mg/m <sup>3</sup> (*)

(\*)Deri më 1 janar 2017 dhe pa asnjë paragjykim për ligjin “Për mbrojtjen e mjedisit” dhe ligjin “Për lejet e mjedisit”, vlera kufi e shkarkimit për NO<sub>x</sub> nuk do të zbatohet për impiantet që djegin vetëm mbetje të rrezikshme.

Agjencia Kombëtare e Mjedisit mund të autorizojë deri më 1 janar 2019 përjashtime për NOx nga impiantet ekzistuese të incinerimit me një kapacitet nominal ndërmjet 6 dhe 16 tonë në orë, me kusht që vlerat mesatare gjysmorëshe të mos i tejkalojnë 600mg/m<sup>3</sup> për kolonën A ose 400 mg/m<sup>3</sup> për kolonën B.

c) Të gjitha vlerat mesatare në periudhën së marrjes së mostrës për 30 minuta (minimumi) dhe 8 orë (maksimumi)

Kadmiumi dhe përbërjet e tij, të shprehura si kadmium(Cd)	total 0,05 mg/m <sup>3</sup>	total 0,1 mg/m <sup>3</sup> (*)
Taliumi dhe përbërjet e tij, të shprehura si talium (Tl)		
Mërkuri dhe përbërjet e tij, të shprehura si Mërkur (Hg)	0,05 mg/m <sup>3</sup>	0,1 mg/m <sup>3</sup> (*)
Antimoni dhe përbërjet e tij, të shprehura si antimon (Sb)		
Arseniku dhe përbërjet e tij, të shprehura si arsenik (As)		
Plumbi dhe përbërjet e tij, të shprehura si plumb (Pb)		
Kromi dhe përbërjet e tij, të shprehura si krom (Cr)		
Kobalti dhe përbërjet e tij, të shprehura si kobalt (Co)	total 0,5 mg/m <sup>3</sup>	total 1 mg/m <sup>3</sup> (*)
Bakri dhe përbërjet e tij, të shprehura si bakër (Cu)		
Mangani dhe përbërjet e tij, të shprehura si mangan (Mn)		
Nikeli dhe përbërjet e tij, të shprehura si nikel (Ni)		
Vanadiumi dhe përbërjet e tij, të shprehura si vanadium (V)		

Këto vlera mesatare mbulojnë gjithashtu format e gazta dhe të avullta të shkarkimeve përkatëse të metaleve të rënda dhe përbërjet e tyre.

(\*) Deri më 1 janar 2017 vlerat mesatare për impiantet ekzistuese për të cilat leja e mjedisit ose leja e operimit është dhënë para datës 31 dhjetor 1996 dhe që incinerojnë vetëm mbetje të rrezikshme.

d) Vlerat mesatare duhet të maten gjatë periudhës së marrjes së mostrës prej 6 orë (minimumi) dhe 8 orë (maksimumi). Vlera kufi e shkarkimit i referohet përqendrimit total të dioksinave dhe furaneve të llogaritur mbi bazën e konceptit të ekuivalencës toksike në përputhje me anksin 1.

Dioksinat dhe furanet	0,1 ng/m <sup>3</sup>
-----------------------	-----------------------

e) të përqendrimeve të monoksidit të karbonit (CO) në gazet e djegies (me përjashtim të fazës së fillimit dhe të mbylljes) nuk duhet të tejkalojnë vlerat kufi të shkarkimeve të mëposhtme:

- 50 miligramë/m<sup>3</sup> të gazit të djegies të përcaktuar si vlerë mesatare ditore;
- 150 miligramë/m<sup>3</sup> të gazit të djegies në të paktën 95% të matjeve të përcaktuara si vlera mesatare gjysmorëshe të marra gjatë çdo periudhe 24 orëshe.

Agjencia Kombëtare e Mjedisit mund të autorizohen përjashtime për impiantet e incinerimit që përdorin teknologjinë me shtrat të lëngëzuar, me kusht që leja e mjedisit të parashikojë një vlerë kufi shkarkimi për monoksidin e karbonit (CO) prej jo më shumë se 100mg/m<sup>3</sup> si vlerë mesatare në orë.

#### ANEKSI VI FORMULA QË LLOGARIT PËRQENDRIMIN E SHKARKIMEVE SIPAS PËRQINDJES STANDARDE TË PËRQENDRIMIT TË OKSIGJENIT

$$E_s = \frac{21 - O_s}{21 - O_M} \times E_M$$

$E_s$  = përqendrimi i shkarkimit i llogaritur sipas përqindjes standarde të përqendrimit të oksigjenit

$E_M$  = përqendrimi i matur i shkarkimit

$O_s$  = përqendrimi standard i oksigjenit

$O_M$  = përqendrimi i matur i oksigjenit



**UDHËZIMI**  
**Nr. 3, datë 16.2.2012**

**PËR PROCEDURAT, KRITERET E PËRFITIMIT TË KREDISË DHE MËNYRA E ADMINISTRIMIT TË FONDEVE KUNDËRPARTI, TË MBLEDHURA NGA GRANDET JAPONEZE, NË ZBATIM TË VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 602, DATË 24.8.2011 “PËR MIRATIMIN E MËNYRËS SË PËRDORIMIT TË FONDEVE KUNDËRPARTI, TË MBLEDHURA NGA GRANDET JAPONEZE PËR SEKTORIN E BUJQËSISË DHE TË USHQIMIT”, TË NDRYSHUAR.**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 602 datë 24.8.2011 “Për miratimin e mënyrës së përdorimit të fondeve kundërparti, të mbledhura nga grandet japoneze për sektorin e bujqësisë dhe të ushqimit”, të ndryshuar

**UDHËZOJMË:**

**1. TË PËRGJITHSHME**

Fondet kundërparti, të krijuara nga arkëtimet prej subjekteve që kanë përfituar nga projekti i Qeverisë Japoneze dhe të mbledhura nga Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural (AZHBR), në shumën 200,000,000 (dyqind milionë) lekë, të derdhen në buxhetin e shtetit. Ky fond të përballohet nga buxheti i akorduar i vitit 2012 për skemën mbështetëse në bujqësi, nga artikulli 606, zëri “Transfertë në buxhetet familjare”.

1.1 Fondet kundërparti të ripërdoren për financimin e projekteve investuese në bujqësi apo agroindustri, në formën e huave pa interes me kohëzgjatje 7-vjeçare, me qëllim nxitjen dhe rritjen e prodhimit bujqësor e blegtoral, si dhe përpunimit të këtyre produkteve.

1.2 Përkufizime: Kudo që mund të përdoren këto terma në këtë udhëzim, përveç rasteve kur thuhet ndryshe, termat e mëposhtëm do të kenë kuptimin si vijon:

- Fondet kundërparti (Fondi), nënkupton fondin total prej 200,000,000 lekë, të miratuar nga Qeveria Shqiptare, do të ripërdoren nga AZHBR-ja në formën e huas pa interes.

- “Komisioni i vlerësimit dhe i miratimit” (Komisioni) nënkupton strukturën më të lartë vendimmarrëse, përgjegjëse për vlerësimin dhe miratimin e kredisë për projektet të cilat financohen.

- “Sekretariati nënkupton” strukturën e AZHBR-së, të ngritur me urdhër të Drejtorit të AZHBR-së, e cila kontrollon përputhshmërinë, kontrollon nga ana formale dokumentacionin e subjekteve aplikues.

- “Hua” nënkupton shumën e miratuar për financimin e projekteve investuese në formën e kredisë pa interes për çdo subjekt.

- “Disbursim” nënkupton lëvrimin e huas në llogaritë e subjekteve përfituese.

- “Subjekti përfitues” nënkupton ato subjekte për të cilat komisioni ka miratuar dhënien e huas.

- “Këst” është shuma e përcaktuar që subjektet duhet të paguajnë për kthimin e huas, në intervale kohore të përcaktuara në kontratë.

- “Periudhë grace” (Grace), periudha gjatë së cilës subjekti përfitues, në bazë të kushteve të kontratës nuk paguan këste.

**2. STRUKTURA MENAXHUESE DHE ADMINISTRIMI I FONDIT KUNDËRPARTI**

2.1 Komisioni i vlerësimit dhe i miratimit është përgjegjës për vlerësimin dhe miratimin të projekteve. Komisioni përbëhet nga 6 anëtarë si vijon:

- 2 (dy) përfaqësues nga Ministria e Bujqësisë Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit;

- 1 (një) përfaqësues nga Ministria e Financave;

- 3 (tre) përfaqësues nga AZHBR-ja.

2.2 Kryetari dhe anëtarët e komisionit emërohen dhe shkarkohen nga Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit me propozim me shkrim nga institucionet përkatëse.

2.3 Mbledhja e komisionit zhvillohet sa herë të jetë e nevojshme për të kryer vlerësimin e projekteve investuese, shpalljen e subjekteve përfitues, si dhe për të shqyrtuar huat që janë pjesërisht ose plotësisht të padisbursuara. Vendimet konsiderohen të vlefshme kur në mbledhje marrin pjesë të paktën 4 anëtarë. Vendimet e komisionit merren me shumicë të thjeshtë votash dhe në rastet e votave të barabarta, vota e kryetarit është përcaktuese.

2.4 Agjencia zbatuese. AZHBR është struktura ekzekutive e Fondit e cila është përgjegjëse për menaxhimin e tij. Konkretisht AZHBR është përgjegjëse për:

a) Informimin e aplikuesëve të mundshëm mbi kërkesat dhe procedurat për përfitimin e financimit.

b) Pranimin e aplikimeve dhe dokumenteve nga aplikantët, si dhe dorëzimin e tyre pranë komisionit, për vlerësim.

c) Kryerjen e shërbimit të Sekretariatit të Komisionit të Vlerësimit dhe Miratimit, përfshirë përgatitjen, regjistrimin dhe administrimin e gjithë dokumentacionit zyrtar të veprimtarisë së këtij komisioni.

d) Komunikimin me vlerësuesit e pasurive, për përgatitjen e raporteve të vlerësimit për pasuritë që ofrohen si kolateral.

e) Llogaritjen e vlerës së kështit dhe intervalet e pagesës së tij në bazë të kohëzgjatjes së huas, duke konsideruar 1 vit periudhë grace nga data e disbursimit të fundit.

f) Kontrollin e pagesës së kësteve nga çdo subjekt dhe llogaritjen e kamatëvonesave përkatëse.

g) Hartimin e nënshkrimit të kontratës së huas dhe kontratës së hipotekës/pengut midis AZHBR-së dhe subjekteve përfituese në përputhje me kushtet e miratuara nga komisioni firmoset nga drejtori i AZHBR-së. Kontrata e nënshkruar mes palëve përbën titull ekzekutiv.

h) Përgatitjen e dokumentacionit për vendosjen e barrës siguroese mbi pasurinë/pasurive që do të shërbejnë si kolateral, dhe ndjek realizimin e këtij procesi me zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme (ZRPP) dhe Regjistrin e Barrës Siguroese (RBS).

i) Njoftimin e subjekteve përfitues për kostot e aplikimit deri në livrimin e Fondit, të cilat mbarten nga aplikanti (të gjitha detyrimet që lindin nga vlerësimi i pasurisë/pasurive, noterizimi i kontratave, si dhe nga akti i bllokimit në hipotekë dhe regjistri i barrës siguroese).

j) Kryerjen e disbursimit të huas në përputhje me kushtet e kontratës së huas.

k) Administrimin e Fondit, mbajtjen e llogarive dhe të dhënave për çdo projekt të financuar, dhe përgatitjen e raporteve të nevojshme.

l) Ndjekjen e ecurisë së projekteve dhe pagesave të kësteve sipas skeduleve të miratuara, dhe mbajtjen e dokumentacionit në lidhje me pagesat e kësteve.

m) Monitorimin e zbatimit të projekteve në përputhje me biznesplanin e paraqitur.

n) Ndjekjen e të gjithë procedurave gjyqësore dhe administrative për ekzekutimin e kolateraleve për subjektet që nuk kryejnë pagesën e huas sipas kushteve të kontratës.

### 3. KRITERET E PËRFITIMIT

Përfitojnë subjektet fizike/juridike që përmbushin kriteret e mëposhtme:

- Ushtrijnë aktivitet në një nga fushat përcaktuara, si dhe paraqesin projektinvestim në përputhje me përcaktimet e bëra në vendimet e Këshillit të Ministrave dhe me politikat dhe strategjitë e zhvillimit të MBUMK-së.

- Ofrojnë garanci pasurore (kolateral) për garantimin e kredisë. Si koletarale të pranueshme konsiderohen: pasuri të paluajtshme (toka, ndërtesa, troje); linjat prodhimi/përpunimi, garanci bankare me kohëzgjatje të njëjtë me atë të huas.

- Vlera e kolateralit të ofruar nuk duhet të jetë më pak se 100 % (njëqind për qind) e vlerës së financuar nga AZHBR.

- Nuk kanë detyrime të pashlyera ndaj organeve tatimore, 2- KR/AZHBR, si dhe institucioneve të tjera huadhënëse.

- Nuk janë dënuar për vepra penale.



- Argumentojnë dhe provojnë se financimi i kërkuar nuk ka për qëllim shlyerjen e huave të çdo lloji, të dhëna nga institucionet financiare.

#### **PËR MEKANIKËN BUJQËSORE KUR APLIKANTËT JANË FERMERË**

1. Përfitojnë fermerët që kanë mbi 2 ha tokë bujqësore arë/pemëtoje/ullishte/vresht, ose mbi 5 dynym serrë diellore ose me ngrohje teknike ose fermerë me jo më pak se 10 krerë lopë qumështi ose fermerë/individë që kryejnë shërbime për të tretë.

2. Toka të jetë në pronësi ose në përdorim të aplikantit të paktën për 10 vjet (në rastet e mjeteve mekanike dhe agregateve).

3. Aplikanti të ketë paguar taksën e tokës për të cilën aplikon për vitet 2011- 2012 (në rastet e mjeteve mekanike dhe agregateve).

#### **4. FUSHAT E INVESTIMIT DHE SHKALLA E FINANCIMIT**

Në varësi të llojit të investimit, shkalla e financimit për subjektet përfituese do të jetë si më poshtë:

a) Për blerjen dhe instalimin e dhomave frigoriferike, deri në 60% të vlerës së përlogaritur të investimit, por jo më shumë se 15 (pesëmbëdhjetë) milionë lekë.

b) Për blerjen e linjave të reja ose rinovimin e linjave ekzistuese të seleksionimit, ruajtjes dhe përpunimit të arvoreve, gështenjës dhe shegës, deri në 80% të vlerës së përlogaritur të investimit, por jo më shumë se 35 (tridhjetepesë) milionë lekë.

c) Për ndërtimin apo modernizimin e komplekseve blegtorale për prodhimin e qumështit e të mishit, si dhe instalimin e impianteve të tyre ndihmëse, deri në 50% të vlerës së përlogaritur të investimit, por jo më shumë se 15 (pesëmbëdhjetë) milionë lekë.

d) Për blerjen e mekanikës bujqësore, deri në 8 (tetë) milionë lekë.

e) Për ngritjen e fidanishteve dhe serrave për prodhimin e fidanëve të arrës, deri në 80% të vlerës së përlogaritur të investimit, por jo më shumë se 30 (tridhjetë) milionë lekë.

#### **5. APLIKIMI PËR FINANCIM DHE DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM**

Aplikimet për mbështetje financiare paraqiten në AZHBR, në drejtorinë qendrore Tiranë brenda datës 31.5.2012. Formulari i aplikimit dhe dokumentet e aplikimit dorëzohen në zyrën e protokollit të AZHBR-së. Subjekti aplikues pajiset me një kopje të protokolluar të formularit të aplikimit dhe listën për dokumentacionin e dorëzuar.

Sekretariati, i ngritur me urdhër të drejtorit të AZHBR-së me mbarimin e afatit të aplikimit, brenda 10 ditësh ia përcjell propozimet e përgatitura dhe dokumentacionin e depozituar nga aplikuesit, komisionit të vlerësimit dhe të miratimit.

Pjesë e dokumentacionit është edhe lista emërore e subjekteve aplikimet e të cilëve nuk janë të shoqëruara me dokumentacionin e kërkuar, duke specifikuar mangësitë e konstatuara.

Komisioni i vlerësimit dhe i miratimit, vendos marrjen ose jo në shqyrtim të këtyre aplikimeve të paraqitura me mangësitë e konstatuara.

##### **5.1 DOKUMENTACIONI I KËRKUAR:**

a) Dokumentacioni ligjor. Person juridik/fizik/ fermer-mekanika bujqësore:

i) Ekstraktin e shoqërisë nga QKR dhe statuti i shoqërisë (për personat juridik/fizik);

ii) Vendimi i asamblesë së ortakëve për marrjen e huas pranë AZHBR-së (për personat juridik/fizik);

iii) Dokument identifikimi të aksionerit/ëve dhe administratorit të shoqërisë (për personat juridikë/fizikë);

iv) Dokument identifikimi (pasaportë biometrike kartë identiteti) dhe certifikatë familjare për personat, prona e të cilëve është ofruar si kolateral;

v) Dëshmi penaliteti për aplikantin.

b) Dokumentacioni financiar dhe i lidhur me planin e investimit:

i) Pasqyrat financiare të 3(tri) viteve paraardhëse, kopje të njësuara nga zyra e tatimeve (për bizneset që kanë ushtruar aktivitet gjatë kësaj periudhe);

ii) Vërtetim nga zyra e tatimeve që nuk ka detyrime tatimore;

iii) Vërtetim nga komuna/bashkia dhe mandatarkëtimi përkatës, që vërtetojnë pagesën e taksës së tokës për vitin 2011 dhe 2012 (për fermerët);

iv) Biznesplanin të detajuar (5-7-vjeçar);

v) Oferta, marrëveshje paraprake apo kontrata nga furnitori (shitësi) dhe specifikimet teknike të linjave, makinerive të veçanta, dhomave frigoriferike, projektet e komplekseve blegtorale apo impianteve të tyre ndihmëse dhe mekanikës bujqësore;

vi) Dokumenti mbi statusin e aplikantit nga regjistri i kredisë në Bankën e Shqipërisë.

c) Dokumentacioni në lidhje me kolateralin e ofruar:

i) Fotokopje të noterizuar të certifikatës së pronësisë, shoqëruar me kopjen origjinale të kartelës së pronës, ose vërtetim i pronësisë se për pronën ku do të bëhet investimi të lëshuar jo më herët se 3 muaj nga data e aplikimit.

ii) Dokumenti i pronësisë së shoqëruar me hartë treguese dhe kopje kartelesh në rastet e certifikatës së pronësisë dhe vërtetim pronësie, shoqëruar me hartë treguese për rastet kur dokumenti është vërtetim i pronësisë.

iii) Vlerësimi i pronësisë, nga eksperti përkatës i licencuar, që do të lihet si barrë hipotekare. Vlera imediate e likuidimit të kolateralit të jetë jo më pak se 100% të vlerës së financimit.

## 6. VLERËSIMI

Vlerësimi i projekteve investuese bëhet sipas përparësive për çdo skemë, shpërndarjes gjeografike, si dhe përqasjes me standardet e BE-së.

6.1 Prioritetet sipas skemave dhe shpërndarja e fondeve për çdo skemë.

a) Përparësitë sipas skemave të financimit (nga 1 tek 5 sipas rëndësisë në zbritje)

1. Blerja dhe instalimi i linjave të seleksionimit dhe përpunimit të prodhimit të arroveve, gështenjës dhe shegës.

2. Ngritja e fidanishteve serrave për prodhimin e fidanëve të arrës.

3. Ndërtim apo modernizim i komplekseve blegtorale dhe instalimi i impianteve të tyre ndihmëse.

4. Blerja dhe instalimi i dhomave frigoriferike.

5. Blerja e mekanikës bujqësore.

Radha e shqyrtimit të jetë sipas përparësive të përcaktuara më sipër (1-5). Brenda secilës skemë shqyrtohen të parat aplikimet e zonave prioritare sipas përcaktimeve të bëra në vijim.

Fondet e papërdorura në një nga nivelet e përmendura më sipër i kalojnë nivelit pasardhës.

Renditja përfundimtare do të bëhet në mënyrë të pavarur për çdo skemë, bazuar në shpërndarjen e fondeve dhe sistemit të pikëve të përcaktuara në këtë udhëzim.

b) Shpërndarja e fondeve për çdo skemë:

1. Blerja dhe instalimi i linjave të seleksionimit dhe përpunimit të prodhimit

të arroveve, gështenjës dhe shegës 35 milionë lekë;

2. Ngritjen e fidanishteve dhe serrave për prodhimin e fidanëve të arrës 60 milionë lekë;

3. Ndërtim apo modernizim i komplekseve blegtorale dhe instalimi i impianteve të tyre ndihmëse 40 milionë lekë;

4. Blerja dhe instalimi i dhomave frigoriferike 40 milionë lekë;

5. Blerja e mekanikës 25 milionë lekë.

6.2 Klasifikimi i zonave prioritare për çdo projekt

6.2.1 Blerja dhe instalimi i linjave të seleksionimit dhe përpunimit të prodhimit të arroveve, gështenjës dhe shegës.

Sipas sipërfaqeve me arrore, zonat përfituese klasifikohen në dy kategori, si vijon:

- Zona prioritare 1: qarku Dibër, Tropoja (qarku Kukës), Pogradec, Kolonjë (qarku Korçë)

- Zona prioritare 2: Malësia e Madhe, Puka (qarku Shkodër), qarku Gjirokastër



#### 6.2.2 Ngritjen e fidanishteve dhe serrave për prodhimin e fidanëve të arrës

- Zonë prioritare 1: qarku Elbasan, qarku Kukës (Tropoja), qarku Korçë
- Zonë prioritare 2: qarku Dibër, qarku Korçë, qarku Shkodër, qarku Gjirokastër

Kusht i përgjithshëm përfitimi është pasja për çdo 100 m<sup>2</sup> serre e mjediseve ndihmëse dhe jo me pak se 20 dynym tokë për rrjetin e fidanëve.

6.2.3 Ndërtim apo modernizim i komplekseve blegtorale dhe instalimi i impianteve të tyre ndihmëse.

- Prioriteti 1. Modernizimi i komplekseve blegtorale dhe instalimi i impianteve të tyre ndihmëse si: ujëpirëse automatike, mjelëse mekanike, tanker ftohës për qumështin, pajisje për banjëzim, ngrohjen dhe ventilimin, sisteme të kontrollit automatik të ambientit, impiant për pastrimin mekanik të plehut.

- Prioriteti 2. Ndërtimi dhe zgjerim/rikonstruksioni i ambienteve të komplekseve blegtorale.

Renditja sipas llojeve dhe zonave gjeografike prioritare është si vijon:

Renditja sipas llojeve	Zona prioritare 1*	Zona prioritare 2
Ferma me mbi 50 lopë	Tiranë, Berat, Fier, Durrës, Lezhë	Korçë Shkodër,
Ferma me mbi 100 krerë dele	Kukës, Vlorë, Gjirokastër	Korçë, Berat, Fier, Dibër
Ferma me mbi 100 krerë dhi	Kukës, Vlorë, Gjirokastër	Korçë, Berat, Fier, Dibër
Ferma me mbi 10 dosa	Shkodër, Lezhë, Durrës	Fier, Korçë, Vlorë

Numri i krerëve është kriter në progresion me vlerësimin.

#### 6.2.4 Blerja dhe instalimi i dhomave frigoriferike

Prioritet kanë zonat kryesore të perimeve, si edhe ato zona ku kapacitetet e ruajtjes frigoriferike janë të papërfillshme. Sipas shtrirjes gjeografike, zonat përfituese klasifikohen në dy grupe si vijon:

- Zonë prioritare 1: qarku: Fier, Durrës, Shkodër, Berat, Gjirokastër, Lezhë, Dibër (për frutat).

- Zonë prioritare 2: qarku: Tiranë, Durrës, Vlorë, Elbasan.

Aktivitetet që mbështeten nëpërmjet kësaj skeme do të jenë: blerja dhe instalimi i dhomave frigoriferike për perimet dhe patatën, si edhe për frutat për qarkun e Dibrës.

#### 6.2.5 Blerja e mekanikës bujqësore

Sipas shtrirjes gjeografike, rrethet përfituese klasifikohen në dy zona prioritare, si vijon:

- Zonë prioritare 1: qarku: Fier, Durrës, Berat, Korçë, Elbasan

- Zonë prioritare 2: qarku: Tiranë, Vlorë, Lezhë, Dibër

#### 6.3 Kriteret e vlerësimit. Pikët për vlerësimin e aplikimeve janë si më poshtë:

##### 6.3.1 Zona gjeografike ku do të zhvillohen projektet investuese:

a) Zonat me prioritet 1 25 pikë

b) Zonat me prioritet 2 15 pikë

##### 6.3.2 Statusi i aplikantit

a) Organizatat prodhuese dhe që kooprojnë (sipas legjislacionit në fuqi) 20 pikë

b) Aplikantë individualë (prodhues, tregtues apo fermerë) 15 pikë

\* Sipas qarqeve  
1606

6.3.3 Aplikantë që kanë raportim më të mirë të totalit të huave ndaj totalit të aseteve	15 pikë*
6.3.4 Aplikantë që kanë raportin më të mirë të fitimit neto ndaj këstit vjetor	15 pikë*
6.4 Kriteria specifike	
6.4.1 Aplikantët që kërkojnë të investojnë në linja sa më të plota (cikël të mbyllur) në skemat: 6.2.1; 6.2.2 ; 6.2.3; dhe 6.2.4	15 pikë
6.4.2 Aplikantët që kanë eksperiencë të mëparshme në këtë fushë Skema: 6.2.1 dhe 6.2.2	15 pikë
6.4.3 Për mekanikën bujqësore:	
i) Blerësit e agregateve	15 pikë
ii) Blerësit e traktor + agregate komplet	20 pikë
iii) Blerësit e traktorëve	10 pikë
6.5 Procesi i vlerësimit përfundon 20 ditë pas dorëzimit nga AZHBR-ja të propozimeve dhe dosjeve të plota të të gjitha aplikimeve. Komisioni mund të kërkojë informacion ose dokumente shtesë në rast se e sheh të nevojshme.	
6.6 Ankesat e aplikantëve paraqiten pranë AZHBR-së brenda 15 ditëve pas shpalljes së listës së fituesve. Drejtori i AZHBR-së pas marrjes së ankimimeve ia përcjell Ministrit të MBUMK-së, i cili vendos pranimin apo rrëzimin e ankimimit.	
<b>7. DISBURSIMI I HUAS</b>	
Pas shpalljes nga komisioni i vlerësimit të listës së fituesve, AZHBR fillon procedurën e nënshkrimit të kontratave dhe të livrimit të huave në përputhje me kushtet e miratuara.	
Përpara disbursimit të çdo shume AZHBR kontrollon dhe siguron që:	
a) Kontratat janë nënshkruar dhe noterizuar në përputhje me kushtet për të qenë titull ekzekutiv.	
b) Është bërë vendosja e barrës siguroese mbi kolateralin e ofruar.	
c) Subjekti bën sigurimin e pronës nga rreziqet pranë një shoqërie sigurimi.	
d) Subjekti përfitues disponon lejet e nevojshme për kryerjen e investimit dhe ushtrimin e aktivitetit.	
e) Subjekti çel një llogari pranë bankës ku është depozituar Fondi.	
f) Subjekti përfitues paraqet dokumentacion të rregullt tatimor për investimin e kryer.	
g) Çdo disbursim është në përpjesëtim me masën e investimit të vetë përfituesit sipas fushës së investimit dhe shkallës përkatëse të financimit të përcaktuara në këtë udhëzim.	
AZHBR mban një kopje të dokumentacionit të sipërpërmendur dhe kryen disbursimin e huas në numrin e llogarisë së përfituesit në përputhje me kushtet e kontratës.	
Për shumat e padisbursuara brenda afateve të përcaktuara në kontratë, AZHBR informon komisionin, i cili merr vendimet përkatëse.	
<b>8. TË TJERA</b>	
1. Subjekti përfitues është i detyruar të raportojë dhe të japë informacion në AZHBR, për të dhënat që i kërkohen prej tij dhe mban përgjegjësi për saktësinë e tyre.	
2. Shlyerja e huas të jetë me këste, me një periudhë grace 1 (një) vit, që fillon nga data e disbursimit të fundit. Këstet do të jenë 3-mujore, përveç rasteve kur në miratimin nga komisioni është vendosur ndryshe. Kthimi i huas të arkëtohet në llogari rrjedhëse të veçantë të AZHBR-së.	
3. Për rastet e mospagimit në kohë të këstit ose të një pjese të këstit, subjekti përfitues penalizohet me një kamatëvonesë mbi vlerën e shumës së papaguar të këstit, e llogaritur kjo për çdo ditë vonesë. Norma vjetore e interesit për llogaritjen e shumës së kamatëvonesës do të jetë 10 %.	

\* Për këto kriteria pikët e shprehura janë pikë maksimale, për aplikantin që ka treguesit më të mirë. Për aplikantët e tjerë vlerësohet proporcionalisht.





4. Kur subjekti përfitues nuk paguan 2 këste të radhës, të cilat janë pasqyruar në kontratë, AZHBR-së i lind e drejta t'i drejtohet organeve gjyqësore për përmbushjen e detyrimeve kontraktuale.

5. Kur përfituesi nuk plotëson kushtet e kontratës të përcaktuara të lidhur mes palëve dhe kur përfituesi devijon qëllimin e përdorimit të kredisë, AZHBR-ja ka të drejtë të bllokojë disbursimin e kredisë së mbetur dhe të kërkojë kthimin e shumës së disbursuar deri në atë periudhë.

6. Çdo kërkesë për ndryshim në kolateral do të merret në shqyrtim vetëm pasi të jenë paraqitur të gjitha dokumentet sipas përcaktimeve të këtij udhëzimi, të jetë bërë vlerësimi nga ekspertët vlerësues për kolateralin e ri të ofruar dhe të jenë shlyer këstet sipas përcaktimeve të bëra në kontratën e huas. Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit ngre një komision për shqyrtimin e kërkesave për ndryshime në kolateral. Të gjitha shpenzimet e lidhura me këtë proces, mbulohen nga aplikantët.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletore Zyrtare.

MINISTRI I BUJQËSISË, USHQIMIT DHE  
MBROJTJES SË KONSUMATORIT  
**Genc Ruli**

MINISTRI I FINANCAVE  
**Ridvan Bode**

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.**

Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë.  
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 9.4.2012  
Doli nga shtypi më 11.4.2012

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare  
Tiranë, 2012

Çmimi 48 lekë